




Bashkia
ELBASAN



Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar

2025 – 2028

Gusht 2025





Të nderuar qytetarë, mësues, prindër dhe të rinj të Elbasanit,

Elbasani është dhe mbetet një djep i çmuar i dijes dhe kulturës shqiptare, një qytet ku historia ka ecur në një hap me librin, ku mësimi ka qenë gjithmonë një akt sublim për jetën dhe për vendin.

Në rrugët e tij kanë marrë frymë breza mësuesish, dijetarësh e nxënësish që kanë ndriçuar rrugën e shoqërisë sonë, duke e kthyer Elbasanin në një emblemë të formimit qytetar dhe arsimor ndër breza. Pikërisht mbi këtë trashëgimi të

ndritur, ne ndërtojmë sot me përkushtim të ardhmen e fëmijëve tanë, duke e parë arsimin jo vetëm si domosdoshmëri, por si mision qytetar dhe si mundësi për ta bërë Elbasanin një qendër të dijes edhe për brezat që vijnë.

Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar është një dokument strategjik, që synon të adresojë sfidat ekzistuese, të përmirësojë infrastrukturën, të fuqizojë shërbimet mbështetëse psiko-sociale dhe të garantojë një sistem arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të ndërtuar mbi parimin e barazisë për çdo fëmijë dhe të ri në territorin tonë.

Ky plan nuk është thjesht një dokument, por një vizion i përbashkët për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për fëmijët dhe të rinjtë tanë. Ai përfaqëson përkushtimin tonë për t'i dhënë çdo fëmijë dhe nxënësi mundësinë të shfrytëzojë potencialin e tij të plotë, pavarësisht vendbanimit apo sfidave sociale.

Hartimi i këtij plani është mbështetur në një proces bashkëpunimi me drejtues institucionesh arsimore, mësues, ekspertë, organizata partnere, prindër dhe përfaqësues të komunitetit lokal. Kontributet e tyre kanë ndihmuar në pasurimin e dokumentit dhe në pasqyrimin më të mirë të nevojave dhe prioriteteve lokale në fushën e arsimit. Mirënjohje për angazhimin dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve në hartimin e politikave arsimore gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Ne besojmë se asnjë vendimarrje për të ardhmen nuk ka vlerë pa zërin dhe përfshirjen e komunitetit.

Ftojme të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat që të vazhdojnë të japin mbështetjen dhe kontributin e tyre, sepse arsimi është mission i përbashkët. Bashkë mund të ndërtojmë një Elbasan, ku çdo fëmijë ka mundësinë të lulëzojë, të mësojë dhe të ëndërrojë pa kufij.

Me respekt,

Kryetari i Bashkisë

Gledian Llatja



Përmbajtje

1.	Hyrje dhe konteksti.....	5
	• Profili demografik dhe social i bashkisë Elbasan.....	6
	• Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor:.....	10
2.	Përmbledhje ekzekutive	12
	• Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar.....	12
	• Prioritetet kryesore:.....	15
	• Përmbledhje e strukturës dhe aktiviteteve të planit	16
3.	Analiza e shërbimit të arsimit parauniversitar	19
	• Arsimi parashkollor:	19
	• Arsimi bazë.....	25
	• Arsimi i mesëm i përgjithshëm.....	27
	• Arsimi profesional:	29
4.	Objektivat dhe masat strategjike	31
	• Objektivat e përgjithshme.....	31
	• Masat strategjike	32
5.	Planifikimi i burimeve financiare	34
	• Burimet financiare vendore	34
	• Burime financimi të tjera	35
6.	Aktivitete dhe planifikimi i zbatimit	36
7.	Përmbledhje e investimeve kapitale	46
8.	Monitorimi dhe vlerësimi.....	47
9.	Rishikimi dhe përshtatja e planit.....	50
10.	Raportimi dhe transparenca.....	51
	Anekse.....	53
	• Të dhëna demografike dhe statistikore.....	53
	• Lista e institucioneve arsimore.....	55
	• Kuadri ligjor dhe rregullativ	65
	• Plan i investimeve kapitale.....	
	• Indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit.....	66
	• Buxheti i detajuar	
	• Lista e aktorëve të përfshirë	66
	• Rezultatet e konsultimeve publike	66

1. Hyrja

Arsimi është një nga prioritetet strategjike të bashkisë Elbasan, që planifikon, projekton dhe mbështet të gjitha përpjekjet për të arritur cilësinë në procesin e shërbimit arsimor. Vizioni ynë është të ndërtojmë një sistem arsimor që ofron mundësi të barabarta për çdo fëmijë, duke e mbështetur atë jo vetëm në aspektin infrastrukturor, por edhe në politikat e përfshirjes sociale, aksesit dhe mirëqenies së nxënësve.

Në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, bashkitë kanë kompetenca të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për institucionet arsimore. Korniza ligjore e decentralizimit, ku i referohemi VKM. nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020”, nxit një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet pushtetit vendor dhe institucioneve arsimore për të garantuar shërbime efikase dhe të qëndrueshme.

Plani i Arsimit Parauniversitar dhe hartimi i politikave zhvilluese e strategjike që priten të ndiqen dhe të zbatohen janë në përputhje me prioritetet kryesore të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026 dhe rekomandimet e qeverisë shqiptare për agjendën e integritetit në BE. Ai mbështetet mbi një proces gjithëpërfshirës dhe ndërveprues ku janë angazhuar specialistë të fushës, institucione vendore, përfaqësues të shkollave, komunitetit dhe aktorë të tjerë.

Procesi i planifikimit ka kaluar në disa faza:

- Ngritja e grupit të punës dhe zhvillimi i konsultimeve paraprake;
- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave për të identifikuar nevojat dhe sfidat;
- Hartimi i draftit paraprak të dokumentit;
- Konsultimi publik dhe miratimi përfundimtar në Këshillin Bashkiak.


Ky dokument synon të shërbejë si një udhërrëfyes për vendimmarrjen, me qëllim që arsimi në bashkinë Elbasan të jetë më cilësor, gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt nevojave reale të komunitetit dhe standardeve bashkëkohore evropiane.

1.1 Profili demografik dhe social i bashkisë Elbasan:

Bashkia Elbasan është bashkia qendër e qarkut Elbasan, pjesë e 12 qarqeve në Republikën e Shqipërisë, e cila shtrihet në pjesën qendrore të saj. Me organizimin e ri pas Reformës Territoriale të vitit 2015, bashkia Elbasan përbëhet nga 12 njësi administrative: Bradashesh, Shushicë, Shirgjan, Papërr, Gjergjan, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Tregan, Funar, Gracen dhe Zavalinë, ndërsa zona urbane e bashkisë është e organizuar në 6 lagje.

Sipas të dhënave të vitit 2024, popullsia totale e bashkisë Elbasan rezulton 217.578 banorë, prej të cilëve 134,058 jetojnë në zonën urbane të qytetit (në 6 lagje), ndërsa 83,520 banorë banojnë në zonat rurale. Lagjja 3 ka dendësinë më të lartë të popullsisë në qytet, ndërkohë që Bradasheshi është njësi administrative me densitetin më të lartë, prej 16225 banorësh.

Grafiku nr.1 Popullsia sipas lagjeve dhe njësive administrative - Bashkia Elbasan (2024)




Tendencat demografike tregojnë rritje të popullsisë gjatë dekadës së fundit në qytet dhe në disa njësi administrative si Papër, Tregan, Shirgjan, Shushicë dhe Labinot-Fushë. Ndërkohë, njësitë si: Gracen, Gjinar, Zavalinë, Funar dhe Labinot-Mal kanë rënie të popullsisë. Zona urbane përbën aktualisht rreth 62% të popullsisë rezidente.

Sipas Censit të vitit 2023, popullsia rezidente në bashkinë Elbasan është 115.101 banorë, e shpërndarë si më poshtë:

- 0–14 vjeç: 17,787 banorë
- 15–64 vjeç: 75,295 banorë
- Mbi 65 vjeç: 22,019 banorë

Grafiku nr.2 Të dhëna për grupmoshat e popullsisë sipas Cens 2023

Të dhëna sipas Cens 2023 për grupmoshat



Referuar të dhënave të OSHP-së për vitin 2024, popullsia rezidente në moshë arsimore (1–18 vjeç) është 17,078 fëmijë.

Sipas të dhënave të “Strategjisë Kombëtare të Arsimit” 2021–2026, ndryshimet demografike në Shqipëri pritet të sjellin zhvillime të reja në përbërjen e popullsisë për moshat e reja në vitet në vijim. Në këtë kuadër, planifikimi arsimor merr një rëndësi të veçantë, me synimin për t’iu përshtatur dinamikave të komunitetit dhe për të garantuar akses e cilësi të qëndrueshme në arsim për çdo fëmijë e të ri.

Kjo nënkupton nevojën për politika të bazuara në të dhëna të sakta dhe analiza të thelluara të tendencave demografike, të cilat do të mundësojnë parashikimin e saktë të kërkesave për infrastrukturë, staf mësimor, burime financiare dhe mbështetje sociale. Njësitë vendore, si aktorë kyç në zbatimin e politikave arsimore në territor, janë angazhuar në forcimin e kapaciteteve të tyre planifikuese dhe bashkëpunojnë ngushtësisht me institucionet qendrore për të siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë sistemit arsimor për shkak të faktorëve gjeografikë, ekonomikë apo socialë.


Tabela 1. Projektionet demografike për vitet 2019 dhe 2031

Grup-mosha	Skenari i rritjes së ulët		Skenari i rritjes së mesme		Skenari i rritjes së lartë	
	2019	2031	2019	2031	2019	2031
0-5	189,482	139,425	189,482	177,822	189,482	220,884
6-14	303,942	229,289	303,942	256,250	303,942	286,323
15-17	117,562	89,882	117,562	92,285	117,562	95,161
18-24	326,612	198,442	326,612	206,577	326,612	216,216
< 25 vjeç	937,598	657,038	937,598	732,934	937,598	818,584
15-64	1,965,787	1,646,671	1,965,787	1,712,808	1,965,787	1,793,968
65+	403,216	577,585	403,216	599,110	403,216	621,572
Të gjithë	2,862,427	2,592,970	2,862,427	2,745,990	2,862,427	2,922,747
(Burimi: Baza e të dhënave statistikore, INSTAT, shkurt 2020)						

Elbasani shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe mbulon një sipërfaqe prej 872.3 km². Territori i saj është i shtrirë dhe i larmishëm, çka ndikon drejtpërdrejt në shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore. Aktualisht, 88 godina arsimore ndodhen në zonat rurale, duke reflektuar përhapjen territoriale të shërbimeve arsimore.

Elbasani është një qytet me prani të dukshme të elementeve etnokulturorë, duke përfshirë një bashkëjetesë të qëndrueshme të minoriteteve: rom, egjiptian, dibran, arumun, vllleh, etj. Ndër këto, pakicat kombëtare më të përfaqësuara numerikisht janë egjiptianët me rreth 5,661 banorë dhe romët me rreth 2,500 banorë. Një tjetër aspekt social i rëndësishëm për t'u theksuar është numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike. Afro 3634 familje (14498 individë) përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, nga të cilat 372 familje i përkasin minoritetit rome¹. Bashkia Elbasan ofron gjithashtu lehtësira dhe mbështetje të dedikuara për fëmijët e pakicave rome dhe egjiptiane, nëpërmjet programeve sociale dhe mbështetjes financiare për kategori të veçanta.

Grafiku nr. 3 Pakicat kombëtare dhe familjet me ndihmë ekonomike.



Në fushën e përfshirjes sociale, 194 fëmijë me aftësi ndryshe ndjekin arsimin parauniversitar në territorin e bashkisë. Në qytet ofron shërbimin vetëm një institucion i specializuar për arsimimin e 52 fëmijëve me aftësi ndryshe, që është shkolla speciale “Zëra jete” pjesa tjetër është e integruar në institucionet arsimore publike:

- 50 fëmijë në arsimin parashkollor
- 142 fëmijë në arsimin bazë
- 19 nxënës në arsimin e mesëm

¹ Statistika vendore 2024, bashkia Elbasan. <https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/Statistika-vendore-2024-Elbasan.pdf>

Sfidat në nivel lokal

Sfidat me të cilat përballlet bashkia Elbasan lidhen me uljen e numrit të popullatës në nivel lokal dhe lëvizjen e brendshme demografike, e cila ka sjellë si pasojë dhe rrudhjen e numrit të popullatës me moshë shkollore sidomos në zonat rurale. Gjithashtu, përmirësimi i infrastrukturës arsimore është një tjetër sfidë, me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve të arsimit parauniversitar. Me uljen e numrit të popullatës, planifikimet dhe investimet duhet të parashikohen në kuadër të shpërndarjes demografike të tanishme dhe projeksionit për numrin e popullsisë në bashkinë Elbasan.

1.2 Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor

Kuadri i politikave të ndjekura nga bashkia Elbasan për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar mbështetet nga strategjitë qendrore e lokale, si dhe dokumente të tjera të politikave që ndërlidhen me zhvillimin e arsimit, siç janë:

1.2.1 Akte kushtetuese dhe ligjore

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**
 - Neni 57/1: “Kushdo ka të drejtën për arsimim”. Kjo e drejtë përbën bazën mbi të cilën ndërtohen politikat dhe funksionet publike në arsim.
- **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**
 - Nenet 22 dhe 23: E kategorizon arsimin parauniversitar si funksion i deleguar, duke ngarkuar bashkitë me detyra për ndërtimin, mirëmbajtjen, funksionimin dhe mbështetjen infrastrukture të institucioneve arsimore.
- **Ligji nr. 69/2012, i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**
 - Rregullon sistemin arsimor dhe përfshin bashkitë si ofrues të shërbimeve ndihmëse (logjistikë, kushte mjedisore, siguri, transport) për institucionet parashkollore dhe bazë.
- **Ligji nr. 48/2018 “Ligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’,**
 - Përcakton strukturën dhe funksionimin e sistemit parauniversitar, rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore në administrimin e arsimit parashkollor (duke përfshirë emërimin e drejtorëve të kopshteve nga Kryetari i Bashkisë), ky ligj rregullon standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore,
- **Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**
 - Përcakton rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore në parandalimin e braktisjes së shkollës dhe kthimin e fëmijëve në sistemin arsimor.
- **Ligji nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”**
 - Parashikon përfshirjen e bashkive në planifikimin dhe mbështetjen e arsimit profesional në nivel vendor.
- **Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**

- Përcakton autonominë financiare të bashkive dhe përgjegjësinë për menaxhimin e fondeve në funksion të zhvillimit, përfshirë arsimin.
- **Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale”**
 - Përcakton organizimin territorial të bashkisë Elbasan në 12 njësi administrative të rëndësishme për planifikimin dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore.

1.2.2 Akte nënligjore dhe udhëzime mbështetëse

- **VKM. Nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020”**
 - Mundëson përparim në drejtim të zbatimit të funksioneve të përbashkëta në sistemin e arsimit, duke fuqizuar bashkëpunimin edhe me institucionet përgjegjëse për arsimin.
- **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 ‘Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare publike në Republikën e Shqipërisë”**
 - Miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, rregullon organizimin dhe mënyrën e funksionimit të shkollave dhe kopshteve në nivel vendor, duke përcaktuar detyrat administrative, përgjegjësitë e stafit dhe mekanizmat e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

1.2.3 Dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare

- **Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2021–2026**
 - Thekson se arsimi parashkollor administrohet nga pushteti vendor dhe kërkon forcimin e bashkëpunimit me pushtetin qendror për financim dhe cilësi.
- **Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025**
 - Bashkitë kanë rol në përfshirjen e këtyre fëmijëve në shkolla publike dhe në mbështetjen me shërbime ndihmëse.
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025**
 - Bashkitë janë aktorë kyç për sigurimin e aksesit të barabartë në arsim për grupet vulnerabël.
- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030**
 - Nxiti përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe gjithëpërfshirjen sociale përmes rolit aktiv të bashkive.
- **Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (Objektivi 4 – Arsimi Cilësor)**
 - Përcakton synimet për arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë me angazhimin e njësive vendore si aktorë për zbatimin në nivel lokal.

1.2.4 Dokumente strategjike vendore

- **Plani për përmirësimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor 2024-2026**

- Parashikon harmonizimin e 13 aktiviteteve për përmirësimin e shërbimit në kopshte mbështetur tek proceset e menaxhimit dhe ato mbështetëse.
- **Plani strategjik vendor “Politika dhe Strategji për përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme në bashkinë Elbasan 2023–2027”**
 - Ka në fokus fuqizimin e kapaciteteve vendore për administrimin e arsimit parashkollor, përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve për fëmijët e grupmoshës 0–6 vjeç.

2. Përmbledhje ekzekutive

2.1 Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar është një dokument strategjik dhe operativ i hartuar në nivel lokal, që përcakton objektivat afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e sistemit arsimor në territorin e qytetit të Elbasanit.

Ky plan:

- parashikon dhe planifikon nevojat arsimore të komunitetit në nivel lokal;
- koordinon burimet njerëzore, financiare dhe infrastrukturore;
- ndihmon në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies përmes rijimit të kushteve fizike falë investimeve;
- siguron përfshirje gjithëpërfshirëse dhe barazi në arsim;
- mbështet rritjen e aksesit në arsim cilësor.

Vizioni i Bashkisë Elbasan siguron parimet e barazisë dhe diversitetit, që mundëson formim cilësor të fëmijëve dhe nxënësve në edukim përmes zgjerimit të rrezes së këtij shërbimi në qytet, duke kontribuar të arrijë kushte më të mira për mirërritjen dhe mirëqenien e tyre, mundësi integrimi në tregun e punës dhe mundëson forcimin e karakterit demokratik e përgatitjen e tyre si përfaqësues të denjë në kuadër të integritit në Bashkimin Europian.

Qëllimi i dokumentit “Plani Vendor i arsimit parauniversitar, bashkia Elbasan” është të përcaktojë objektivat dhe të ndërtojë planin e veprimtari për përmbushjen e vizionit të caktuar. Bashkia Elbasan është në përputhje të programit qeverisës, i cili vazhdon të ketë në fokus të veçantë fushën e arsimit, si një e mirë kombëtare dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e çdo qytetari. Nevoja për hartimin e këtij plani e vendos pushtetin lokal (në këtë rast bashkinë Elbasan) përpara hartimit të politikave dhe strategjive afatgjata, të cilat do të jenë në funksion të mbështetjes së punës për të siguruar mirëqenie dhe mbështetje cilësore për fëmijët e nxënësit. Për të realizuar mbarëvajtjen e politikave, bashkia Elbasan synon të planifikojë strategjitë dhe politikat vendore për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrohet për arsimin parauniversitar, duke identifikuar fillimisht nevojat dhe kërkesat për përmirësim, konsultimet me grupet e interesit, kostimin e planit dhe indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit për zbatimin e tij.

Qëllimi i planifikimit: Ky plan ka për qëllim të identifikojë nevojat për përmirësim dhe ndërhyrje në veprimtarinë që ushtrojnë institucionet e arsimit parauniversitar: parashkollor, bazë, arsimit të mesëm i përgjithshëm dhe arsimit profesional, duke u fokusuar në sigurimin dhe përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve organizuese e menaxhuese të këtyre institucioneve, nëpërmjet hartimit të një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse, e cila do të krijojë bazat për zhvillim të qëndrueshëm për vitet në vijim, në funksion të përmirësimit të kushteve të arsimit dhe mundësive për të zhvilluar aftësitë dhe vlerat e kërkuara nga shoqëria.

Metodologjia

Për realizimin e këtij plani u hartua urdhri i Kryetarit të Bashkisë Elbasan për ngritjen e grupit të punës, i cili konsiston në pjesëmarrjen e: specialistë dhe ekspertë të fushës në institucionin e bashkisë Elbasan, drejtues të institucioneve të bashkisë, drejtues të institucioneve arsimore parauniversitare nën juridiksionin e bashkisë, përfaqësues të këshillit bashkiak, përfaqësues nga organizata të ndryshme si pjesë e grupeve të interesit. Ky grup drejtoi gjithë procesin e hartimit të “Plani i arsimit parauniversitar në bashkinë Elbasan”, duke krijuar grupe më të vogla pune të përbëra nga specialistë të fushës, përfaqësues të organizatave partnere dhe palëve të interesuar. Angazhimi i pjesëtarëve të grupit të punës ka qenë rigoroz dhe me impakt ndjeshmërie për një fushë të rëndësishme dhe me traditë për të gjithë banorët e qytetit të Elbasanit, siç është arsimit.

Gjatë punës për përgatitjen e dokumentit janë realizuar një sërë konsultimesh me aktorë dhe bashkëpunëtorë të rëndësishëm në nivel të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të interesit. Për mbledhjen e informacionit të vlefshëm janë shfrytëzuar të dhënat e marra nga dokumentet e politikave kombëtare, dokumentet e politikave rajonale dhe atyre lokale, të dhëna statistikore nga institucioni i bashkisë, me qëllim që të kemi një bashkërendim të strategjive dhe politikave në nivel planifikimi kombëtar e lokal.

Dokumenti “Plani i Arsimit Parauniversitar” është përpjekur të ndërlidhë në një kuadër të integruar analizën e thelluar të gjendjes aktuale, parashikimin e nevojave të tanishme dhe të ardhshme të bashkisë së Elbasanit, nevojat për ndërhyrje dhe koordinimin e ideve të studimit me politikat kombëtare dhe lokale.

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar i bashkisë Elbasan, mbështetur në vizionin e këtij dokumenti, ka si qëllim të politikave strategjike:

“Garantimin e një shërbimi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë fëmijët dhe nxënësit, përmes sigurimit të kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe kapaciteteve menaxhuese të institucioneve arsimore, ngritjes së mekanizmave funksionale për cilësinë, transparencën dhe llogaridhënien, si dhe nxitjes së zhvillimit social e kulturor të nxënësve përmes mbështetjes me veprimtari”

Qëllimet e politikave strategjike lokale:

Vizioni: Sigurimi i parimit të barazisë dhe diversitetit, që mundëson formim cilësor të fëmijëve dhe nxënësve në edukim në bashkinë Elbasan, duke kontribuar të arrijë kushte më të mira për mirërritjen, mirëqenien dhe edukimin e tyre, mundësi integrimi në tregun e punës dhe duke mundësuar forcimin e karakterit demokratik e përgatitjen e tyre si përfaqësues të denjë të shoqërisë në kuadër të integritit në Bashkimin Europian.		
Qëllimi i politikës 1: Shërbim arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte për të gjithë fëmijët, pa asnjë dallim, që garanton bazat për zhvillim të qëndrueshëm mbi sigurimin e kushteve dhe kapaciteteve menaxhuese të institucioneve të arsimit parauniversitar.	Qëllimi i politikës 2: Menaxhim efektiv dhe eficient i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksionale për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies.	Qëllimi i politikës 3: Mbështetja përmes veprimtarive jashtëshkollore, që nxisin zhvillimin social dhe kulturor, për të garantuar sistem arsimor të drejtë dhe të cilësisë së lartë për të gjithë fëmijët e nxënësit në bashkinë Elbasan.

Plani i Arsimit Parauniversitar luan një rol të shumëfishtë për zhvillimin lokal:

Planifikimi dhe efica nca në përdorimin e burimeve

Ndihmon bashkinë Elbasan të parashikojë numrin e fëmijëve e nxënësve në vite, nevojat për mësues, nevojat për ndërtime godinash, rehabilitime institucione sh arsimore, pajisjen me logjistikën e nevojshme dhe materiale didaktike. Ky planifikim ndihmon në reduktimin e shpenzimeve të panevojshme dhe rritjen e efektivitetit në menaxhim. Gjithashtu ndihmon në orientimin drejt arsimit profesional, thithje investimesh apo mbështetje për realizim aktivitete sh nga donatorë të ndryshëm. Plotësim të standardeve në ofrimin e shërbimeve në arsimin parauniversitar.

Promovimi i cilësisë në arsim

Plani përfshin masa për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë, modernizimin e metodologjive dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies përmes investimeve, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e rezultateve të nxënësve.

Ndërthurja me zhvillimin socio-ekonomik të bashkisë Elbasan

Një arsim cilësor është i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik, punësimin dhe stabilitetin social. Përmes këtij plani, bashkia Elbasan investon në kapitalin njerëzor të së ardhmes.

Përshtatja me nevojat lokale

Plani merr parasysh kontekstin lokal: pakicat kombëtare, zonat rurale, vështirësitë socio-ekonomike dhe mundëson ndërtimin e një sistemi arsimor të drejtë dhe gjithëpërfshirës, ku respektohet barazia dhe diversiteti.

Përfshirja e aktorëve lokal

Plani ndërtohet me pjesëmarrjen ekspertëve, specialistëve të fushës, punonjësve të angazhuar në fushën e arsimit, komuniteteve, prindërve dhe organizatave të shoqërisë civile, duke rritur transparencën dhe ndjenjën e pronësisë mbi procesin arsimor.

Në këtë kontekst, Plani i Arsimit Parauniversitar nuk është thjesht një dokument formal, por është një mjet udhëzues për zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejtuar nga nevojat reale të komunitetit. Në kontekstin e decentralizimit të kompetencave në arsim, roli i bashkive në tërësi dhe bashkisë Elbasan në veçanti, në hartimin dhe zbatimin e këtij plani është thelbësor për garantimin e të drejtës për arsim cilësor për çdo qytetar të ri.

Aspektet të shërbimit që adreson Plani i Arsimit Parauniversitar

Proceset e menaxhimit:

- Gjithpërfshirja: Planifikimi dhe regjistrimi i fëmijëve
- Organizmat e institucionit arsimor
- Financimi

Proceset kryesore:

- Përfshirja sociale
- Mbrojtja e fëmijës
- Fëmijët me aftësi ndryshe

Proceset mbështetëse:

- Menaxhimi i godinave
- Burimet njerëzore
- Materialet dhe shërbime mbështetëse

2.2 Prioritetet kryesore

Në kuadër të hartimit dhe zbatimit të një plani efektiv për arsimin parauniversitar në nivel bashkie është thelbësore të identifikohen prioritetet strategjike, të cilat shërbejnë si boshti udhëheqës për ndërhyrjet e nevojshme. Këto prioritete mbështeten në analiza të nevojave

arsimore dhe synojnë përmirësimin e cilësisë, barazisë dhe qasjes në arsim. Për realizimin e këtij qëllimi, bashkia Elbasan vendos si prioritet:

Prioritetet e bashkisë Elbasan në kuadër të përmbushjes së Planit të Arsimit Parauniversitar:

1. Investimi dhe përmirësimi në infrastrukturë, rritja e cilësisë së shërbimit arsimor, zhvillimi profesional i mësuesve dhe fuqizimi i bashkëpunimit me komunitetin, në funksion të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe qytetari aktive.
2. Hartimi i politikave dhe planifikimeve strategjike lokale në funksion të përmirësimit të shërbimit arsimor në zonat e juridiksionit të bashkisë Elbasan si dhe nxitja e përfshirjes dhe barazisë në arsim.
3. Bashkëpunim ndërinstitutional, pjesëmarrje e komunitetit dhe përthithje e përvojave më të mira, lidhur me aspekte të menaxhimit efektiv të sistemit arsimor parauniversitar në të gjitha nivelet e tij.

2.3 Përmbledhje e strukturës dhe aktiviteteve të planit

Plani i Arsimit Parauniversitar është i organizuar në bazë të niveleve të ndryshme të sistemit arsimor dhe përfshin planifikimin e aktiviteteve të posaçme për secilin nivel dhe në përputhje me objektivat e këtij plani. Struktura e tij është e ndarë në katër fusha veprimtarie kryesore, të cilat synojnë përmirësimin cilësor dhe gjithëpërfshirës të arsimit në territorin e bashkisë Elbasan.

2.3.1 Objektiva specifike sipas qëllimeve të politikave:

Objektivi 1.1 Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë efektive për pagesat e personelit mësimor dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e ambienteve me kushtet e përshtatshme (ngrohje, furnizim me ujë, higjenë) furnizimin me mjete didaktike dhe logjistike, shërbimet ushqimore dhe të transportit për fëmijët.

Objektivi 1.2 Të planifikojë ndërtimin, rregullimin dhe rehabilitimin e institucioneve të arsimit, duke siguruar ofrimin e një infrastrukture bashkëkohore për të plotësuar nevojat dhe interesat e fëmijëve dhe nxënësve të bashkisë së Elbasanit.

Objektivi 1.3 Të bashkëpunojë me institucionet e pushtetit qendror për realizimin e politikave të hartuara mbi arsimin si: paketat lehtësuese financiare; procesi i regjistrimit; identifikimi i fëmijëve në nevojë), racionalizimi i rrjetit të shkollave përmes rajonizimit dhe të vihet në funksion një sistem digjital për menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave të institucioneve arsimore.

Objektivi 2.1 Të përmirësojë cilësinë e shërbimit në arsimin parashkollor, duke krijuar kushtet e përshtatshme fizike dhe arsimore përmes menaxhimit të kurrikulës dhe kapaciteteve njerëzore, forcimit të shërbimit psiko-social dhe shërbimin e logopedit për fëmijët me nevoja ndryshe.

Objektivi 2.2 Të sigurohet aspekti gjithëpërfshirës i shkollimit të detyrueshëm për çdo fëmijë, duke iu përgjigjur sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor e të mesëm të ulët dhe mbështetje për aftësinë e kufizuar përmes transformimit të shkollës speciale në qendër burimore.

Objektivi 2.3 Të rritet përfshirja e fëmijëve nga grupet vulnerabël (romë, egjiptianë, me aftësi ndryshe, etj.), duke respektuar parimin e barazisë dhe diversitetit, si dhe të mundësohet mbështetje financiare nëpërmjet programit të bursave për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabël, me qëllim përfshirjen e tyre në arsim, sidomos edhe në arsimin e mesëm.

Objektivi 2.4 Të forcohet bashkëpunimi me komunitetin, duke i përfshirë në procesin arsimor përmes forumeve dhe këshillave të shkollës, partneriteti me organizata joqeveritare dhe sektorin privat për mbështetjen e arsimit, si dhe të krijohet një sistem lokal monitorimi dhe raportimi për ecurinë e shkollave.

Objektivi 2.5 Të zgjerohet përfshirja në arsimin profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës lokal dhe rajonal, duke nxitur bashkëpunimin mes shkollave profesionale dhe bizneseve për të zhvilluar module duale të praktikës profesionale.

Objektivi 2.6 Të krijohen kushte të përshtatshme infrastrukturore për garantimin e akomodimit të nxënësve që vijnë nga larg dhe ndjekin arsimin profesional.

Objektivi 3.1 Të fuqizohet i rrjetit të shkollave Qendër Komunitare, duke siguruar projekte dhe bashkëpunime konkrete në kuadër të arsimit dhe edukimit gjithëpërfshirës.

2.3.2 Aktivitetet kryesore për arsimin parashkollor (3–6 vjeç):

- Planifikim për ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e institucioneve të arsimit parashkollor, duke përfshirë ndërtimin e palestrave, këndeve të lojrave, mjediseve çlodhëse etj, me qëllim zgjerimin e rrjetit të institucioneve publike.
- Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor, nëpërmjet veprimtarive të mirëplanifikuara në institucionet e arsimit parashkollor dhe në shkollat e arsimit bazë që kanë klasa përgatitore me qëllim rritjen e përfshirjes së fëmijëve në këtë nivel arsimor. Bashkia, në bashkëpunim me specialistët e sektorit të arsimit, administratorët e lagjeve dhe njësive administrative, si dhe me drejtueset e kopshteve dhe shkollave, do të organizojë fushata sensibilizuese dhe takime me prindër e anëtarë të komunitetit. Në këto takime do të theksohet roli i arsimit parashkollor në zhvillimin e fëmijëve 3-6 vjeç dhe rëndësia e përgatitjes së tyre për të nisur klasën e parë me vetëbesim, njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime në përputhje me kërkesat e kurrikulës.
- Trajnime profesionale dhe kualifikuese në kuadër të arritjes dhe fuqizimit të standardeve të mësuesit parashkollor dhe krijimi i databazës elektronike për regjistrimin dhe frekuentimin e fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor.

- Përfshirja dhe angazhimi i logopedëve në institucionet e arsimit parashkollor që kanë fëmijë me aftësi ndryshe dhe konsolidimi i shërbimit psiko-social në kopshte.
- Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e pushtetit qendror për ngritjen e Komisionit Multidisiplinar në nivel bashkie. Nisma të bashkisë për të mbështetur ngritjen e komunikimit shkollë-prindër-qeveri, përfaqësimi në bordet e institucionit arsimor. Takim me prindërit në çdo shkollë, ku zbatohet nisma "Bëjmë detyrat në shkollë" për të komunikuar dhe sugjeruar vijueshmërinë e aktiviteteve.
- Planifikimi i paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë përfshirjeje, duke mundësuar lehtësira financiare për përballimin e frekuentimit në kopshtet me ushqim në një numër më të lartë fëmijësh.

2.3.3 Aktivitetet kryesore për arsimin bazë (klasat I–IX):

- Hartimi dhe zbatimi i një plani vjetor për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore së institucioneve arsimore të bashkisë Elbasan dhe realizimi i projekteve të rehabilitimit për shkollat me probleme fizike dhe teknike.
- Rajonizimi i institucioneve arsimore parauniversitare, me qëllim arsimimin në klasa normale në bazë të projeksioneve demografike dhe mundësive për sigurimin e transportit.
- Pajisja e shkollave me materiale dhe teknologji mësimore bashkëkohore.
- Kujdes i shtuar për transportin dhe përmirësimi i këtij shërbimi për nxënësit që jetojnë në zona të largëta.
- Bashkëpunimi me institucionet arsimore për ndjekjen e fëmijëve jashtë sistemit shkollor.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për rëndësinë e arsimit dhe luftimin e braktisjes shkollore.
- Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.
- Trajnimi i stafit arsimor dhe administrativ për përmbushjen e standardeve të reja arsimore.
- Ndërtimi i partneriteteve me OJF dhe donatorë për mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës.
- Bashkëpunimi me strukturat komunitare këshilluese (prindër, nxënës, komunitet) pranë shkollave dhe Këshillin Vendor të Arsimit Parauniversitar² për vendimmarrje dhe mbështetje vendore
- Hartimi i planit financiar mbështetës për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë.
- Hartimi i studimit për racionalizimin e rrjetit të shkollave.

² Këshilli Vendor i Arsimit Parauniversitar është organi këshillimor në nivel qarku

2.3.4, Aktivitetet kryesore për arsimin e mesëm (klasa X – XII):

- Ndërhyrje për rehabilitimin e godinave të arsimit të mesëm dhe krijimin e mjediseve për aktivitete jashtëshkollore.
- Investime në logjistikë dhe mjete në funksion të procesit mësimor.
- Sigurimi i aksesit për nxënësit me aftësi ndryshe nëpërmjet instalimit të rampave dhe ambienteve të përshtatura.
- Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve në rrezik largimi nga arsimi i mesëm, përmes mentorimit, mbështetjes psikologjike dhe ekonomike.
- Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera
- Organizimi i klubeve shkollore dhe aktiviteteve sportive ose artistike, për të rritur motivimin dhe përfshirjen e nxënësve në kuadër të rrjetit të shkollave si qendër komunitare.
- Krijimi i forumeve të rregullta me prindër, mësues dhe nxënës për vendimmarrje pjesëmarrëse.
- Organizimi i ditëve të hapura të shkollës për të rritur transparencën dhe komunikimin me komunitetin.

2.3.5 Aktivitetet kryesore për arsimin profesional:

- Investimi në shkollat profesionale (infrastrukturë dhe pajisje)
- Partneritet me bizneset për praktika dhe kurrikula të përbashkëta.
- Fushata për ndërgjegjësimin e të rinjve mbi përfitimet e formimit profesional.
- Organizimi i panairove të karrierës në bashkëpunim me bizneset lokale dhe shkollat profesionale.

Ngritja e moduleve të praktikës profesionale për nxënësit në bashkëpunim me biznese, zyrat e punës, ose sektorin publik dhe promovimi i modeleve të suksesshme.

3. Analiza e shërbimit të Arsimit Parauniversitar

3.1 Arsimi parashkollor:

Reforma territoriale dhe miratimi i ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i njeh të drejtën pushtetit lokal, konkretisht bashkisë së Elbasanit për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe. Në bashki funksionon Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor që nga viti 2016, e cila ka në përbërjen e saj punonjës nga fusha e arsimit. Prej viti 2024, kjo drejtori (DPAP) punon sipas planit “*Politika dhe strategji për përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme në bashkinë e Elbasanit*” 2023-2027 dhe “*Planit për përmirësimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor*” 2024-2026 dokumente strategjike të miratuara në Këshillin bashkiak të Elbasanit.

Aktualisht, bashkia e Elbasanit ka në funksionalitetin e saj 3 çerdhe dhe 106 kopshte (si institucione arsimore parashkollore më vete dhe/ose grupe brenda/jashtë godinave³ të institucioneve arsimore parauniversitare). Sipas të dhënave statistikore të bashkisë Elbasan, lidhur me numrin e fëmijëve që kanë frekuentuar kopshtet deri në vitin 2025 kemi:

Tabela nr. 2 Numri i fëmijëve që kanë frekuentuar kopshtet.

Viti shkollor	Nr. total i fëmijëve	Femra	Meshkuj	Egjiptian	Rom	fëmijëve me AK	Mësues ndihmës
2024-2025	3033	1507	1426	266	72	50	12

Shpërndarja e kopshteve në bashkinë e Elbasanit


Në zonën urbane të bashkisë së Elbasanit ndodhen rreth 37 objekte arsimore, ku ofrohet arsim parashkollor, përfshirë këtu kopshtet me drejtori dhe anekset në varësi të tyre si dhe klasat përgatitore në shkollat e arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të bashkuar. Ndërsa në njësitë administrative ose në zonën rurale ndodhen rreth 71 objekte arsimore, ku ofrohet arsim parashkollor përfshirë këtu grupet parashkollore në mjediset e shkollave të arsimit bazë që i kanë në organikë ose në godina jashtë mjediseve të shkollave, qofshin këto në inventarin e bashkisë ose me qira nga bashkia.

Në bashkinë e Elbasanit kryejnë funksionin e tyre 17 kopshte me drejtori, nga të cilat:

- 8 prej tyre janë kopshte me ditëngrënie
- 9 të tjerat janë kopshte pa ditëngrënie;
- 16 kopshte janë në zonën urbane të bashkisë;
- 1 kopsht ndodhet në zonën rurale;

Në çdo rajon ndodhet mesatarisht 1 kopsht me ushqim dhe 1 kopsht pa ushqim.

Grafiku nr. 4 Ndarja e kopshteve sipas Lagjeve



³ Sepse ka edhe godina jashtë mjediseve të shkollave që janë në inventarin e bashkisë ose janë marrë me qira nga bashkia për kopshte dhe shkolla.

Në zonën rurale të bashkisë së Elbasanit numri më i madh i banorëve është në Bradashesh, ku është dhe numri më i lartë i kopshteve në njësi, me 4 shkolla drejtori dhe rreth 9 kopshte në varësi me 16 klasa parashkollore.

65% e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuara në zonën urbane të bashkisë së Elbasanit ose më saktë, 11 shkolla të arsimit bazë dhe 2 shkolla të mesme të bashkuara kanë në strukturën e tyre arsim parashkollor, pasi kanë klasa përgatitore. Situata e klasave përgatitore pranë institucioneve arsimore të ciklit 9-vjeçar ose të mesëm të bashkuar në juridiksionin e Elbasanit është e trashëguar prej vitesh.

Tabela nr. 3 Shpërndaja e klasave përgatitore

Nr.	Institucioni arsimor	Numri i klasave përgatitore
1	“Ali Agjah”	1
2	“Bardhul Popa”	2
3	“Fadil Gurmani”	1
4	“Fejzullah Guranjaku”	1
5	“Hamit Mullisi”	1
6	“Jorgji Dilo”	1
7	“Naim Frashëri”	1
8	“Qemal Haxhihasani”	1
9	“Sul Misiri”	1
10	“Onufri”	1
11	“Luigj Gurakuqi”	2
12	“Alush Lleshanaku”	1
13	“Sulejman Rranci”	1

33% e shkollave 9-vjeçare kanë në mjediset e tyre grupe parashkollore, të cilat nuk i kanë në organikën e tyre pasi janë në varësi dhe statistikë të kopshteve me drejtori sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 4 Grupet e kopshteve në godinë të shkollave


Nr	Shkolla ku ndodhen	Kopshti që i ka në varësi	Nr i klasave
1	“Jeronim de Rada”	Kopshti 6	1
2	“Ptoleme Xhuvani”	Kopshti 4	2
3	“Naim Frashëri”	Kopshti 11	1
4	“Sulë Domi”	Kopshti 17	2
5	“Abdyl Paralloi”	Kopshti 11	4
6	“Xhaferr Hakani”	Kopshti 15	1

94% ose të gjitha shkollat “qendër” në njësitë administrative (me përjashtim të dy shkollave të mesme të veçanta) kanë në organikën e tyre kopshte.

Tabela nr. 5 Shperndarja e kopshteve në zonën rurale

Nr.	Njësia Administrative	Arsimi	Shkolla	Nr i klasave /grupeve
1	Bradashesh	9-vjeçare	Balëz (Myrteza Gjoni)	3
2	Bradashesh	9-vjeçare	Bradashesh (Alush Lleshanaku)	5
3	Funar	Mes. e bashkuar	Funar (Ibrahim Çeka)	2
4	Shushicë	9-vjeçare	Fushëbull	1
5	Gjergjan	9-vjeçare	Gjergjan (Xhemal Jança)	4
6	Gjinar	9-vjeçare	Gjinar (26 Shtatori)	3
7	Gracen	9-vjeçare	Gjormë	4
8	Labinot Fushë	9-vjeçare	Godolesh (A.Keta)	2
9	Labinot Fushë	9-vjeçare	Griqan Poshte (Musa Bica)	2
10	Labinot Mal	9-vjeçare	Gur i Zi	2
11	Shushicë	9-vjeçare	Hajdaran (Riza Salla)	2
12	Shirgjan	9-vjeçare	Jagodinë (Ismail Kasa)	2
13	Bradashesh	9-vjeçare	Katund i Ri (Europa)	2
14	Shirgjan	9-vjeçare	Kuqan	7
15	Bradashesh	9-vjeçare	Kusarth (Florenc Balla)	3
16	Labinot Fushë	Mes. e bashkuar	Labinot Fushë (Sali N.Ballkoci)	2
17	Labinot Mal	Mes. e bashkuar	Labinot Katund (11 Dëshmorët)	2
18	Gjinar	9-vjeçare	Lleshan	2
19	Labinot Fushë	9-vjeçare	Mengël (Sulejman Rranci)	3
20	Shushicë	9 -vjeçare	Mlizë	2
21	Funar	9-vjeçare	Mollagjesh (Isuf Deliu)	1
22	Papër	9-vjeçare	Pajun	1
23	Papër	Mes. e bashkuar	Papër (Fiqiri Baltëza)	1
24	Labinot Mal	Mes. e bashkuar	Qafë (Ibrahim Bozhiqi)	1
25	Labinot Mal	9-vjeçare	Qerret	3
26	Labinot Mal	9-vjeçare	Sericë	1
27	Shushicë	9-vjeçare	Shelcan (Jonuz Topuzi)	2
28	Tregan	9-vjeçare	Shilbatër	3
29	Shushicë	9-vjeçare	Shushicë	4
30	Gjergjan	9-vjeçare	Thanë (Ali Sollaku)	2
31	Tregan	9-vjeçare	Tregan (Jonuz Çarçiu)	4
32	Papër	9-vjeçare	Vidhas (Seit Pepa)	2
33	Labinot Fushë	9-vjeçare	Xibrakë (R.Bala)	1
34	Zavalinë	Mes. e bashkuar	Zavalinë	1

Pjesa më e madhe e kopshteve, rreth 84% e tyre, ndodhen brenda mjediseve të shkollave, ndërsa një pjesë e vogël ose 16% ndodhen në godina të veçanta jashtë ndërtesave të shkollave, ku 5 kopshte janë në mjedise me qira nga bashkia.

Grafiku nr. 5 Shpërndarja e kopshteve në godina

Lagjet me densitet më të madh popullsie janë: lagjja nr. 3 (28361 banorë), lagjja nr. 1 (23445 banorë), lagjja nr. 2 (23299 banorë), lagjja nr. 4 (22214 banorë), lagjja nr. 6 (21689 banorë), lagjja nr. 5 (13820 banorë), ndërsa njësitë e tjera administrative vijojnë me numër më të vogël banorësh.

Rreth 116 fëmijë ose 3.46% e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet i përkasin familjeve në nevojë apo që trajtohen me ndihmë ekonomike. Vetëm 10% e tyre kanë frekuentuar kopshtet me ushqim, ku 41% përfitojnë ushqim pa pagesë nga bashkia si pjesë e një projekti me organizatën “Save the Children”.

Rreth 7% e fëmijëve 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike janë të komunitetit rom dhe egjiptianë. Pjesa më e madhe fëmijëve të komunitetit egjiptianë, rreth 90% e tyre janë në zonën urbane të bashkisë së Elbasanit, ndërsa pjesa tjetër në zonën rurale. Fëmijët e komunitetit rom janë të gjithë në zonën urbane. Këtë vit shkollor kopshtet publike i kanë frekuentuar rreth 221 fëmijë të komunitetit egjiptianë dhe 76 fëmijë të komunitetit rom. 18% e tyre ose 40 fëmijë kanë frekuentuar kopshtet me ushqim, ku 60% e tyre përfitojnë ushqim pa pagesë nga bashkia, ndërsa pjesa tjetër kanë frekuentuar ato pa ushqim.

Densiteti fëmijëve për çdo kopsht është 31.5 fëmijë. Densiteti i fëmijëve për çdo çerdhe është mesatarisht 125 fëmijë/çerdhe. Bashkia Elbasan nuk aplikon taksë për arsimin, gjë që krijon mungesë në mledhjen e të ardhurave për këtë qëllim. Për të përmbushur zbatimin e politikave në fushë të arsimit përdoren të ardhura nga buxheti i bashkisë, si dhe nga bashkëpunimi me pushtetin qendror dhe me organizatat jofitimprurëse.

Identifikimi i sfidave dhe mundësive për përmirësim në përputhje me standardet kombëtare apo vendore

- Nevoja për ndërhyrje në infrastrukturë dhe përmirësim i kushteve për zhvillimin e hershëm të fëmijëve;
- Kërkesa për praninë e stafit të kualifikuar për arsimin parashkollor, sidomos në aspektin trajnues;
- Unifikimi i bazës materialeve didaktike në funksion të lojrave edukative bashkëkohore;

- Mungesa e shërbimeve shtesë, pas orarit të frekuentimit të kopshtit;
- Përfshirje më e gjerë e fëmijëve nga komunitetet në nevojë, si romë, egjiptianë apo fëmijë me aftësi ndryshe;
- Krijimi i programeve për përfshirjen gjithëpërfshirëse dhe monitorimi i përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Partneritete me organizata dhe projekte që synojnë zhvillimin e hershëm të fëmijërisë.

Mundësitë për përmirësim:

- Planifikimi i fushatës ndërgjegjësuere të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor, nëpërmjet veprimtarive të mirëplanifikuara në nivel të institucioneve të arsimit parashkollor dhe shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, me qëllim frekuentimin e arsimit parashkollor nga të gjithë fëmijët.
- Krijimi i mjediseve rekreative pranë këtyre kopshteve, minipalestrave, territoreve sportive apo kalimi i kopshteve me ushqim do të përmirësonte cilësinë e shërbimit të ofruar, përthithje më të lartë të numrit të fëmijëve dhe sigurinë e prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.
- Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore.
- Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme, veçanërisht për ofrimin dhe fuqizimin e shërbimit psiko-social.
- Inkurajimi dhe nxitja e hapjes së strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është: argëtimi, loja, sporti etj
- Përmirësimi i kushteve dhe standardeve të institucioneve arsimore parashkollore dhe të fëmijërisë së hershme nëpërmjet ndërtimit, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave të këtyre institucioneve për zhvillimin e procesit edukativ dhe mirërritës në kushte të përshtatshme në të gjithë territorin administrativ të bashkisë Elbasan.
- Përmirësimi i kushteve me anë të sigurimit të bazës materiale dhe unifikimin e bazës didaktike për shërbimin arsimor parashkollor, me qëllim funksionimin sa më normal të objekteve shkollore. Rritja e sigurisë në ambientet arsimore parashkollore dhe krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët nëpërmjet shërbimit të rojeve të sigurisë publike dhe monitorimit me anë të sistemit të kamerave.
- Përmirësimi i sistemeve të edukimit parashkollor e fëmijërisë së hershme përmes zhvillimit profesional e trajnimit profesional, duke realizuar ndërlidhjen e politikës arsimore me politikat zhvillimore të bashkisë Elbasan.
- Ngritja e Komisionit Multidisiplinar në nivel bashkie, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e fëmijëve me nevoja ndryshe që në moshë të hershme.
- Mbështetje dhe fuqizim i shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parashkollor.
- Planifikimi i paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë përfshirjeje, duke mundësuar lehtësira financiare për përballimin e frekuentimit në kopshtet me ushqim.
- Ofrimi i shërbimit të logopedit në institucionet e arsimit parashkollor.

3.2 Arsimi bazë

Pas reformës së decentralizimit, pushteti lokal ka marrë përgjegjësi të zgjeruara në menaxhimin e arsimit parauniversitar, përfshirë arsimin bazë. Sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, bashkia Elbasan ka kompetenca të deleguara dhe përgjegjësi të drejtpërdrejta për menaxhimin e arsimit bazë në territorin e saj. Funksionet kryesore përfshijnë aspekte që lidhen me administrimin e infrastrukturës shkollore, e cila përfshin menaxhimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e godinave të arsimit bazë.

Gjithashtu, pushteti lokal investon në sigurimin e kushteve bazë, si: ngrohje, furnizim me ujë, higjienë, ndriçim dhe siguri në shkolla. Për ndërtimin e mjediseve të reja në zonat me rritje të popullsisë ose me mungesë kapaciteti, bashkia projektton dhe vendos në zbatim nevojat për ndërhyrje. Kuadri ligjor ngarkon me përgjegjësi pushtetin lokal dhe për sigurimin e shërbimeve ndihmëse, siç janë: sigurimi i kushteve për transport të sigurt për nxënësit, mbulimi i shërbimeve sanitare, ngrohje për institucionet arsimore, ujë të pijshëm, mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta.

Bashkia e Elbasanit ka një rrjet prej 66 institucionesh arsimore⁴, të cilat ndahen në:

- 50 institucione të arsimit bazë;
- 16 institucione të arsimit të mesëm;

Institucionet arsimore ndahen sipas zonave: 18 në zonat urbane dhe 32 në zonat rurale. Në vitet e fundit vërehet një prirje e qartë, zvogëlimi i numrit të fëmijëve/nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, që është rezultat i tkurrjes së popullsisë rezidente, si për shkak të uljes së lindshmërisë, ashtu edhe për shkak të migrameve apo lëvizjeve demografike. Në përputhje me prioritetet qeverisëse dhe në mbështetje të parimit të barazisë e diversitetit për pakicat rome, në bashkinë Elbasan (1 institucion arsimor) ofrohet mësim edhe në gjuhën rome. Duke qenë se numri i popullatës rome është i konsiderueshëm në qytet, synojmë zgjerimin e mësimdhënies në gjuhën rome, duke bashkëpunuar ngushtë me MAS.

Regjistrimet e nxënësve:

Lidhur me situatën e regjistrimeve të nxënësve në arsimin bazë kryhet përmes portalit e-Albania. Në bashkinë Elbasan është evidentuar rënia e numrit të nxënësve për shkak të emigracionit dhe rënies së lindshmërisë. Në zonat periferike ose rurale, regjistrimi nuk është gjithmonë i plotë, veçanërisht për vajzat dhe komunitetet vulnerabël. Mungesa e një sistemi të posaçëm digjital për regjistrimin dhe gjurmimin e bën të vështirë identifikimin në kohë të fëmijëve jashtë sistemit. Ligji 69/2012 (i ndryshuar) “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” përcakton se njësia e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin

⁴ Të dhënat janë marrë nga faqja e ZVA Elbasan, Karta e Performancës

parauniversitar përkatëse dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë. Shpeshherë ka edhe mospërputhje të të dhënave ndërmjet bashkisë dhe njësisë vendore për braktisjen shkollore. Në këtë kontekst synohet forcimi i kapaciteteve për bashkëpunim me njësinë arsimore vendore në funksion të ndërhyrjes kundër braktisjes shkollore dhe zbatimi i politikave lokale për reduktimin e braktisjes shkollore dhe nxitjen e pjesëmarrjes së komunitetit.

Infrastruktura shkollore:

Gjithëpërfshirja ka qenë në fokus të politikave arsimore në Shqipëri në dekadën e fundit, por edhe një nga prioritetet e bashkisë Elbasan, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël. Pushteti lokal është i angazhuar të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, por ende duhet të ngrihen disa themele të rëndësishme për pjesëmarrjen në arsim të gjithë fëmijëve me aftësi ndryshe. Shkollat janë në fokusin e përmbytjes së të gjitha standardeve të gjithëpërfshirjes, duke treguar angazhim të veçantë për infrastrukturën dhe ambientet fizike në shkolla, apo pajisjet për aftësitë e kufizuara.

Ekziston një element pabarazie në infrastrukturë midis shkollave urbane dhe rurale. Disa institucone arsimore në zonat rurale janë të amortizuara, me mungesë ngrohjeje dhe nevoja për përmirësim në linjat e ndriçimit dhe kushtet sanitare. Në këtë kontekst, investimet duhet të bazohen në një analizë të mirë të numrit të nxënësve apo projeksioneve demografike.

Shërbimet ndihmëse:

Tri aspekte të shërbimeve ndihmëse në funksion të bashkisë Elbasan do të jenë në fokusin e përmirësimit për arsimin bazë:

- Sigurimi i kushteve për shërbimin e transportit, i cili ka nevojë për një qasje përmirësuese, sidomos në zonat e thella të bashkisë Elbasan.
- Shërbimi psiko-social si strukturë më e specializuar për të bashkëpunuar me psikologë dhe punonjës socialë, meqenëse këta janë thelbësorë për nxënësit në nevojë.
- Dakordësim me komunitetin dhe prindërit për të ofruar shërbimet e ushqimit në institucionet arsimore, të cilat janë të kufizuara.

Identifikimi i sfidave dhe mundësive për përmirësim, në raport me standardet apo objektivat vendore

- Pushteti lokal karakterizohet nga aspekte buxhetore relativisht të qëndrueshme për arsimin, për shkak se shpesh varen nga fondet qendrore.
- Fuqizim i kapaciteteve teknike dhe menaxheriale për planifikim dhe zbatim të projekteve arsimore.

- Përmirësimi i të dhënave të sakta, hartimi i planifikimeve dhe analizave demografike për të udhëhequr vendimmarrjen.
- Pjesëmarrje e kufizuar e komunitetit dhe prindërve në vendimmarrjen lokale për arsimin.
- Nevoja për përmirësim të infrastrukturës në disa institucione arsimore.
- Nevoja për materiale mësimore bashkëkohore.
- Angazhim për përfshirje, veçanërisht në komunitetin romë dhe egjiptianë.
- Përmirësim i shërbimit për fëmijët me aftësi ndryshe.

Mundësitë për përmirësim:

- Hartimi i një regjistri elektronik lokal të nxënësve për të ndjekur regjistrimin dhe frekuencimin.
- Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare dhe OJF për financime dhe asistencë teknike.
- Përdorimi i standardeve kombëtare të infrastrukturës dhe shërbimeve për të matur progresin dhe ofruar shërbim cilësor në arsim.
- Fuqizimi i komuniteteve lokale për të marrë pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shkollave.

3.3 Arsimi i mesëm

Pavarësisht se arsimi i mesëm është përgjegjësi kryesore e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe strukturave të saj vartëse, siç janë njësitë arsimore vendore, pushteti vendor ka një rol të rëndësishëm mbështetës, veçanërisht në aspektin infrastrukturor, logjistik dhe të shërbimeve ndihmëse. Bashkia Elbasan është përgjegjëse për mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe pjesërisht, ndërtimin e godinave të arsimit të mesëm në territorin e saj, në bashkëpunim me qeverinë qendrore.

Gjatë viteve të fundit, janë realizuar investime të konsiderueshme për përmirësimin e infrastrukturës së gjimnazeve, ku deri në vitin 2024 janë rikonstruktuar ose rehabilituar plotësisht apo pjesërisht 18 objekte arsimore. Shërbimet mbështetëse përfshijnë furnizimin me ujë të pijshëm, ngrohjen gjatë stinës së ftohtë, masat për sigurinë në shkollë, higjienën, transportin, aksesin për nxënësit me aftësi ndryshe, si dhe ofrimin e mbështetjes sociale për fëmijët në nevojë. Bashkia synon të sigurojë mjedise të sigurta, funksionale dhe higjienike për nxënësit dhe stafin mësimor, duke garantuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor.

Bashkia mban komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me drejtuesit e shkollave për identifikimin e nevojave emergjente dhe ato të planifikuara, që lidhen me mirëmbajtjen ose ndërhyrjet infrastrukturale. Gjithashtu, luan rol në mbështetjen e orientimit në karrierë dhe zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë lokalë.

Bashkia Elbasan ka gjithsej 16 shkolla të arsimit të mesëm, nga të cilat, 8 gjenden në zonën urbane dhe 8 të tjera në zonën rurale. Në zonën urbane janë gjithsej 8 shkolla të arsimit të mesëm, nga të cilët: 2 prej tyre i përkasin arsimit të orientuar (gjimnazi gjuhësor dhe artistike), 1 institucion është në strukturën e shkollës së mesme të bashkuar dhe 6 prej tyre janë të arsimit të mesëm gjimnaz. Institucionet e arsimit të mesëm janë të dy tiplogjive: si gjimnaze dhe si shkolla të mesme të bashkuara. Këto të fundit janë karakteristikë për zonat rurale, por një prej tyre gjendet dhe brenda qytetit.

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm është 3295, nga ku 2965 në zonën e qytetit dhe 330 në zonat rurale. Në vitet e fundit vërehet një prirje e qartë, e zvogëlimit të numrit të nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, që është rezultat i tkurrjes së popullsisë rezidente, si për shkak të uljes së lindshmërisë, ashtu edhe për shkak të migrimeve.

Bashkia Elbasan bashkëpunon me Zyrën Vendore të Arsimit në Elbasan dhe me propozim të përbashkët sugjerojnë për të planifikuar hapjen, mbylljen apo bashkimin e shkollave, bazuar në analizën e demografisë, migrimit dhe frekuentimit shkollor, duke dhënë informacion të dobishëm për hartimin e politikave vendore për edukimin.

Në kuadër të bashkëpunimit me shkollat dhe komunitetin, bashkia Elbasan mbështet gjithashtu edhe organizimin e aktiviteteve kulturore, sociale dhe qytetare në bashkëpunim me shkollat e mesme. Kjo i shërben nxitjes së pjesëmarrjes së komunitetit në mbështetje të shkollave. Përmes kësaj qasjeje, bashkia mbështet projekte të edukimit joformal për të rinjtë.

Në fokusin e punës së bashkisë Elbasan është edhe monitorimi dhe mbështetja e cilësisë së shërbimeve arsimore. Edhe pse nuk ndërhyjnë në përmbajtjen mësimore, pushteti vendor mund të ndihmojë përmes investimeve në teknologji dhe mjedise mësimore për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve, duke krijuar mundësi të financojë programe shtesë si kurse mbështetëse, aktivitete jashtëmësimore, trajnime për mësues etj.

Sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve mbështetëse

- Kufizimi i financimeve të mjaftueshme nga buxheti për arsimin e mesëm.
- Nevojë për planifikim të bazuar në të dhëna reale demografike dhe arsimore.
- Kosto e lartë për modernizimin e godinave të vjetra.
- Shërbime të kufizuara mbështetëse.
- Kërkesa për kapacitete administrative në bashki për të menaxhuar sektorin e arsimit.
- Vështirësi në garantimin e kushteve të transportit dhe infrastrukturës për nxënësit në zona të thella rurale, për shkak të territorit të thyer.

Mundësitë për përmirësim:

- Përdorimi i fondit të zhvillimit rajonal, programeve IPA dhe partneriteteve me donatorë për rikonstrukcione të thella.
- Hartimi i një harte të nevojave reale, bazuar në numrin e nxënësve dhe ecurinë e regjistrimeve për të drejtuar investimet.
- Krijimi i modeleve të bashkëmenaxhimit me komunitetin shkollor për mirëmbajtjen e godinave.
- Zhvillimi i modeleve të gjimnazeve bashkëkohore me pajisje moderne, platforma mësimore dhe trajnime.

3.4 Arsimi profesional

Një ndër komponentët strategjikë për zhvillimin ekonomik dhe përgatitjen e fuqisë punëtore është arsimi profesional. Kuadri ligjor që e rregullon këtë fushë përfshin: ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Politikat e Ministrisë së Arsimit dhe të Agjencisë Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional (AKAFP).

Pushteti vendor nuk ka rol drejtues mbi kurrikulën ose menaxhimin pedagogjik, por ka rol kyç mbështetës, planifikues dhe ndërmjetësues mes shkollave profesionale dhe nevojave të tregut lokal të punës. Edhe pse arsimi profesional mbikqyret nga Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare për Arsimin Profesional dhe Formimin (AKAFP), bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm mbështetës, veçanërisht në nivelin lokal.

Në kuadër të planifikimit të zhvillimit të arsimit profesional në nivel vendor, bashkia Elbasan ka përgjegjësi të kontribuojë në identifikimin e nevojave lokale për profesione dhe profile të reja shkollore. Bashkia jep kontribut në zhvillimin e rrjetit të institucioneve të arsimit profesional në përputhje me strategjitë e zhvillimit lokal dhe ekonominë vendore duke siguruar komunikim të vazhdueshëm me shkollat profesionale që veprojnë në territorin e saj, si dhe duke koordinuar me Ministrinë e Arsimit dhe AKAFP për projekte zhvillimore dhe përmirësime në infrastrukturë.

Funksioni tjetër shumë i rëndësishëm lidhet me ndërmjetësimin që realizon me bizneset dhe tregun e punës. Pushteti vendor luan një rol ndërmjetësues për krijimin e partneriteteve mes shkollave profesionale dhe bizneseve lokale. Gjithashtu, mbështet praktikën profesionale, punësimin sezonal ose të përkohshëm të nxënësve, si dhe krijimin e kurseve të reja që përputhen me kërkesat e tregut, duke e mundur përmes bashkëpunimit ndërsektorial.

Bashkia realizon mbështetjen në infrastrukturë dhe shërbime mbështetëse, duke kontribuar me hapësira publike, investime bashkiake, ose mbështetje për pajisje në shkollat profesionale. Në aspektin mbështetës siguron shërbime ndihmëse si transporti për nxënësit, akses në shërbime sociale për nxënësit në nevojë, bursa ekonomike etj.

Duke qenë se bashkia Elbasan ka një shkollë profesionale, ajo synon nxitjen e regjistrimeve dhe promovimin e arsimit profesional. Për këtë arsye, bashkia Elbasan synon të mbështesë shkollën profesionale të ndërmarrë fushata sensibilizuese për të promovuar rëndësinë e arsimit profesional, si dhe të nxisë pjesëmarrjen e vajzave dhe grupeve të marginalizuara në programe profesionale. Shkolla Profesionale Elbasan është e përqendruar në dy godina dhe kanë kapacitet prej afro 1332 nxënësish⁵, nga të cilët 1191 meshkuj e 141 femra. Drejtimet kryesore të profesioneve janë: TIK, Ekonomi-biznes, Hoteleri turizëm, Shërbime mjete transporti, Mekanikë, Ndërtim, Termohidraulikë, Elektroteknikë, Përpunim druri, Tekstile konfeksione dhe Shërbime sociale e shëndetësore. Rreth 592 nxënës vijnë nga zonat rurale për të marrë profesion dhe 627 nga zonat urbane. Përfaqësuesit e komuniteteve ndahen në: 24 romë dhe 60 egjiptianë. Në shkollën profesionale studiojnë 15 nxënës me nevoja ndryshe. Nxënësit përfitojnë mbështetje finansiare, e cila kategorizohet në: transport, bursë ekonomike dhe mbështetje sociale për 624 nxënës. Arsimi profesional është në fokusin e bashkisë Elbasan, me qëllim që të rinjtë të orientojnë drejt profesionit, si mënyra më e mirë për t'u përfshirë në tregun e punës sa më shpejt.

Identifikimi i sfidave

Në tërësinë e sfidave të funksioneve të bashkisë Elbasan për arsimin profesional do të rendisnim:

- Mungesa e kompetencave të plota ligjore për të menaxhuar arsimin profesional e kufizon rolin aktiv të bashkisë Elbasan;
- Kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe teknike për të analizuar tregun lokal të punës dhe për të planifikuar.
- Perceptimi i ulët i arsimit profesional dhe stigmatizimi i këtij drejtimi shkollor në shumë komunitete, që ende shihet si “zgjidhje e dytë” krahasuar me shkollën e mesme.
- Mospërputhja midis profileve të ofruara dhe nevojave reale të tregut të punës lokal, çka bën që shumë të rinj të mos gjejnë punë pas diplomimit.
- Bashkëpunim jo i mjaftueshëm ndërmjet shkollave dhe bizneseve lokale, për shkak të mungesës së koordinimit institucional.
- Mungesë bashkëpunimi efektiv me aktorët ekonomikë dhe arsimorë për ndërlidhje të qëndrueshme.

Mundësitë për përmirësim

- Hartimi i planeve të zhvillimit vendor me komponentë të qartë për arsimin profesional, duke përfshirë analizën e tregut të punës. Bashkia Elbasan mund të analizojë sektorët potencial për zhvillim (turizëm, industri, teknologji, ndërtim) dhe të ndikojnë në profilizimin e shkollave profesionale në përputhje me to.
- Krijimi i platformave bashkëpunimi tripalëshe: shkollë – biznes – bashki në funksion të zhvillimit të shkollave profesionale për sipërmarrje të ndryshme.

⁵ Të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare e Shkollës Profesionale Elbasan

- Përdorimi i fondeve të donatorëve dhe fondeve të BE-së për të mbështetur shkollat profesionale në territorin vendor.
- Investime në pajisje teknike për laboratorë, IT, makineri profesionale, që bashkia mund të financojë ose të tërheqë fonde të BE dhe partnerë donatorë.
- Krijimi i qendrave multifunksionale rinore me përfshirje të arsimit praktik, formimit profesional dhe startupeve sociale.
- Krijimi i Bordit Vendor për arsimin profesional, me përfaqësues nga shkolla, bizneset dhe bashkia, për të lidhur praktikat mësimore me nevojat e industrisë lokale.

3.5 Institucione plotësuese/mbështetëse

Neni 15 i Ligjit 69/2012 i ndryshuar përcakton dhe funksionimin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve. Qendrat kulturore të fëmijëve janë institucione plotësuese, të cilat janë në varësi të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe hapen me vendim të Këshillit të Ministrave. Bashkia Elbasan ka në funksionim të plotë Qendrën Kulturore të Fëmijëve, institucion i cili organizohet nga puna e instruktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Qendra Kulturore e Fëmijëve në Elbasan ka një numër prej 7 numër punonjësish efektiv dhe 10 të jashtëm. Numri i kursantëve të regjistruar deri në fund të viti 2024 ka qenë 354 fëmijë nga institucionet arsimore parauniversitare në Elbasan.

Qëllimi funksional i QKF është edukimi dhe argëtimi i fëmijëve, kultivimi i prirjeve, mbështetja e talenteve, si dhe formimi i shprehive e shkathtësive. Përveç zhvillimit të kurseve të ndryshme, QKF i vjen në ndihmë jetës kulturore të fëmijëve, por edhe të qytetarëve duke organizuar ndër të tjera:

- Veprimtari të ndryshme artistike;
- Festivalin e këngës për fëmijë,
- Festivali i interpretuesve të rinj;
- Festivali folklorik
- Fest Folk 4.

Institucioni i Qendrës Kulturore të Fëmijëve organizon të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë artistike, kulturore dhe sportive, të cilat financohen nga buxheti i bashkisë dhe janë në mbështetje të arsimit parauniversitar në qytetin e Elbasanit.

4. Objektivat dhe masat strategjike

4.1 Objektivat e përgjithshme

Bashkia Elbasan ka për qëllim fokusin në sigurimin dhe përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve organizuese e menaxhuese të institucioneve arsimore. Për të plotësuar këtë qëllim, politikat vendore dhe strategjitë planifikuese do të kenë një rol shumë të rëndësishëm përmes këtyre objektivave:

- Të përmirësojë cilësinë e shërbimit në arsimin parauniversitar, duke krijuar kushtet e përshtatshme fizike dhe arsimore përmes menaxhimit të kurrikulës dhe kapaciteteve njerëzore, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe edukimit.

- Të koordinojë punën me institucionet e pushtetit qendror për realizimin e politikave të hartuara mbi arsimin, duke angazhuar kapacitetet institucionale lokale për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës, shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimin dhe forcimin e burimeve njerëzore.
- Të zhvillojë në nivel lokal kornizën konceptuese të arsimit në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve sipas parimit të barazisë dhe të bëjë të mundur aksesimin e institucioneve arsimore për të gjithë fëmijët e qytetit të Elbasanit në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe edukimit.

4.2 Masat strategjike

Veprimtari specifike që synohen në sistemin arsimor parauniversitar:

Arsimi parashkollor:

- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore, ndërtimi, rikonstruksioni apo rehabilitimi i godinave dhe krijimi i mjedisve të reja, ku do të shihet si mundësi edhe për grupet e arsimit parashkollor që ndodhen në brendësi të godinave të shkollave.
- Planifikimi për procesin e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore sipas vendbanimit.
- Hartimi i instrumenteve me indikatorët përkatës për monitorimin dhe vlerësimin e performancës për çdo punonjës të arsimit parashkollor, me qëllim përmirësimin e burimeve njerëzore.
- Krijimi i databazës me të dhënat analitike për çdo kopësht, duke përfshirë të dhëna për fëmijët, punonjësit arsimorë dhe mbështetës në institucionet e arsimit parashkollor.
- Planifikim për realizimin efektiv të procesit të mësimdhënies përmes përmirësimit të burimeve njerëzore dhe përditësimit të bazës materiale.
- Krijimin e mundësive për forcimin e shërbimit psiko-social dhe angazhimin e profesionit të logopedit për të gjithë institucionet arsimore parashkollore në funksion të mbështetjes së fëmijëve me nevoja ndryshe.

Arsimi i bazë

- Strukturimi dhe ndarja e cikleve shkollore në godina të veçanta të institucioneve arsimore, pra, në godinë më vete arsimit fillor dhe në godina më vete cikli i arsimit 9-vjeçar. Disa shkolla të qytetit të Elbasanit kanë tipologji për të realizuar me sukses këtë ndarje, duke qenë se kanë afërsi gjeografike (ose brenda një oborri). Kjo ndihmon në menaxhimin më të mirë të procesit mësimor dhe trajtimin në aspektin moshor e psikologjik të tyre.
- Krijimin e qendrave të edukimit në zonat rurale me popullsi të konsiderueshme do të ishte një shërbim arsimor shtesë i nevojshëm. Për këtë mund të shfrytëzohen godinat shtetërore jashtë funksionit dhe mund të angazhohen mësues të gjuhës shqipe, informatikës, gjuhës së huaj dhe matematikës. Në këto qendra synohet të organizohen orë shtesë pas procesit mësimor, ku fëmijët mund të marrin njohuri shtesë në formën e konsultimeve. Një shërbim i tillë do të zbusë mungesën e ndihmës që fëmijët nuk mund

ta gjejnë nga familja, për shkak të angazhimit me punët familjare dhe gjithashtu është një mënyrë për zbutjen e paanësisë dhe uljen e ndasisë në zonë urbane dhe rurale. Është e nevojshme mbulimi i qendrave të edukimit me logjistikën e nevojshme, me ndryshime të dispozitave ligjore dhe mbështetje financiare nga qeveria qendrore.

- Organizimi i konkurseve në nivel lokal për lëndët kryesore (gjuhë shqipe, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi etj), të organizuara nga pushteti lokal, me juri të jashtme për vlerësimin e tyre dhe me shpërblime finianciare për nxënësit dhe mësuesit. Angazhime të tilla do të rrisin ndjeshëm konkurrencën dhe do të përmirësojnë cilësinë në institucionet arsimore.
- Përkujdesje për krijimin e kushteve më të mira për transportin e nxënësve në zonat rurale.
- Mbështetja e nismës “Shkolla qendër komunitare” për të përmirësuar cilësinë e shkollimit. Ofrimi i projekteve konkrete pranë shkollave, me qëllim edukimin e nxënësve me kompetencën e sipërmarrjes dhe sigurimin e të ardhurave nga palët e treta.
- Rritja e sigurisë në ambientet arsimore parashkollore dhe krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët nëpërmjet shërbimit të rojeve të sigurisë publike dhe monitorimit me anë të sistemit të kamerave.
- Bashkëpunim i strukturave të pushtetit lokal dhe institucioneve të arsimit parauniversitar për mbështetjen e nxënësve me nevoja psiko-sociale dhe radikalizimit të dhunës në klasë. Strukturat pranë bashkisë dhe Zyra Vendore Arsimore mund të koordinojnë punën në formën e një rrjeti, me qëllim që adresimi i problematikave të trajtohet nga disa profesionistë.

Arsimi i mesëm

- Rikonstruktion i godinave të amortizuara dhe investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore në bashkinë Elbasan
- Fuqizimi i rrjetit të shkollave Qendër Komunitare përmes angazhimit të projekteve konkrete për zbatim, me qëllim edukimin e nxënësve për sipërmarrjen
- Parashikimi për ofrimin e bursave të ekselencës për nxënësit me rezultate të shkëlqyera.
- Planifikim për mbështetje finianciare për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabël.
- Planifikim për pajisje me bazë didaktike moderne për numrin më të madh të shkollave
- Bashkëpunim dhe mbështetje finianciare për zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe pjesëmarrje në jetën publike.

Arsimi profesional

- Nevoja për të ndërtuar një strategji të dedikuar për arsimin profesional, duke u bazuar në analizën e tregut lokal të punës dhe nevojave të komunitetit.
- Bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional, si institucion mbështetës për arsimin profesional.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me biznese për ofrimin e praktikave profesionale për nxënësit.

- Ofrimi i bursave për nxënësit në nevojë që ndjekin arsimin profesional dhe mbështetje për transportin për nxënësit që jetojnë larg shkollës profesionale.
- Mbështetje për Start-Up rinore dhe dhënia e granteve apo mbështetje me hapësira pune për projektet e tyre të para.

5. Planifikimi i burimeve financiare

Për zbatimin me sukses të Planit të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Elbasan, është thelbësor planifikimi i saktë dhe konkret i burimeve financiare. Buxheti i parashikuar do të mbulojë realizimin e objektivave strategjike dhe aktiviteteve kryesore të planit, duke përfshirë investimet në infrastrukturë, përmirësimin e kushteve mësimore, zhvillimin profesional të mësuesve, si dhe mbështetjen për nxënësit në nevojë.

Burimet financiare vendore

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar dhe arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimit për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë dhe konviktet;
- Funksionimin e Qendrës kulturore të fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, duke përfshirë paratë e personelit mësues dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore. Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit.

Tabelat PBA 2025-2027

AG109 - Arsimi

Shpenzime Personeli (600-601)	450,620	450,620	450,620
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)	131,742	131,742	131,742
Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661)	101,085	103,000	120,000
Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	683,447	685,362	702,362

Burimet njerëzore

Buxheti i detajuar për vitin 2024:

- Fondi i pagave dhe sigurimeve Shoqerore 556819 lekë.
 - Fondi i shpenzimeve operative 166200 lekë.
 - Fondi i shpenzimeve kapitale 135642 lekë.
- Totali i buxhetit 858661 lekë.*

Për vitin 2024 numri i punonjësve:

- Numri i punonjesve te DPAP eshte 68.
 - Numri i punonjesve per DAR eshte 226.
 - Numri i punonjesve mbështetës 219.
 - Numri i punonjesve ndihmes 16.
 - Numri punonjesve me kontrate 19
- Totali 548 punonjës.*

Tabela PBA 2025 – 2027

Burime buxhetore/Transfertë e pakushtëzuar

	Plani 2025	Plani 2026	Plani 2027
<i>Konviktet e arsimit parauniversitar</i>	30.500	30.805	31.113
<i>Arsimi parashkollor -Personeli</i>	257.699	260.276	262.879
<i>Arsimi parashkollor-Stafi mbështetës</i>	71.066	71.777	72.494
<i>Arsimi parauniversitar</i>	40.781	41.189	41.601

Raporti: PBA6 - Deklarata së Politikës së Programit

NJVQV: 109 - Bashkia Elbasan

Programi: AG109 - Arsimi

PBA: 2025 - 2027

Përshkrimi i Politikës së Programit	
Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore; Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollos parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; Shpenzimet për paga për stafin mbështetës. Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave; Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës; Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve; Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve; Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.	

1	Qëllimi i Politikës së Programit	Ofrim i shërbimi të përgjishëm Arsimi I mesëm			
	TP për Qëllimin:	2024	2028		
	Objekte te arsimit e mesem te pergjithshem te mirembajtura (cope)	119242	77304		
1.1	Objektivi i Politikës së Programit	Objekte funksionale per arsimin e mesem te pergjithshem			
	TP për Objektivin:	2024	2025	2026	2027
	Objekte funksionale per arsimin e mesem te pergjithshem (cope)	17	17	17	17
1.2	Objektivi i Politikës së Programit	Objekte te arsimit baze dhe parashkollor funksionale			
	TP për Objektivin:	2024	2025	2026	2027
	Objekte te arsimit baze dhe parashkollor të mirëmbajtura dhe funksionale (130)	130	130	130	130

Standardet e Shërbimeve të Programit	Ofrim i shërbimi të Arsimit cilesor
---	-------------------------------------

6. Aktivitete dhe planifikimi i zbatimit

- **Aktivitetet e planit:** Detajimi i aktiviteteve që do të realizohen për secilën fushë të arsimit (parashkollor, bazë, të mesëm, dhe profesional).
- **Afatet e zbatimit:** Përcaktimi i periudhave të kohës për zbatimin e aktiviteteve, përfshirë afate të qarta dhe kontroll të avancimit.
- **Roli i aktorëve të përfshirë:** Përcaktimi i përgjegjësisë për aktorët kyç që do të implementojnë aktivitete, përfshirë drejtorët e shkollave, këshillat lokalë, dhe autoritetet arsimore.
- **Detajimi i shpenzimeve:** Përcaktimi i shpenzimeve për aktivitetet e planit dhe burimet përkatëse financiare që do të përdoren për implementimin e aktiviteteve të planit.

Plani i veprimtarive (matrica e aktiviteve)

Qëllimi 1 (Q1) – Shërbim arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte për të gjithë fëmijët pa asnjë dallim, që garanton bazat për zhvillim të qëndrueshëm mbi sigurimin e kushteve dhe kapaciteteve menaxhuese të institucioneve të arsimit parauniversitar.

Objektivi 1.1. Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë efektive për: pagesat e personelit mësimor dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e ambienteve me kushtet e përshtatshme (ngrohje, furnizim me ujë, higjenë) furnizimin me mjete didaktike dhe logjistike, shërbimet ushqimore dhe të transportit për fëmijët e nxënësit.

Nr.	Aktivite	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
1	Mbështetja me pagesën dhe sigurimin punonjësve të arsimit (parashkollor, bazë dhe atij të mesëm)	2025–2028	DPAP DF DASHRSMD	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike, Buxhet vendor Transferte e pakushtëzuar	Të dhëna për nr. i punonjësve (mësues, punonjës mbështetës) dhe buxheti në dispozicion të tyre;
	Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të nevojshme: -ngrohje, - ujë, -kushte higjeno-sanitare, -shërbime ushqimore, -logjistikë.	2025–2028	DPAP DF QEA Drejtoria e Shëndetit Publik	Këshilli Bashkiak Operatorët e licencuar	Ky aktivitet nuk është përlogaritur me një kosto totale fikse, pasi zbatimi i tij do të bazohet në nevojat vjetore të secilit institucion arsimor, të cilat ndryshojnë sipas numrit të nxënësve, specifikave të infrastrukturës dhe prioriteteve të planifikimit vendor	-Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare - Nr. i institucioneve me sistem ngrohjeje -Nr. i kopshteve me ushqim -Të dhëna për nr. e fëmijëve të regjistruar në kopësht (familjet në nevojë dhe grupet vulnerabël) që përfitojnë nga shërbimi i arsimit parashkollor -Nr. i institucioneve të furnizuara me mjete didaktike
	Ofrimi dhe sigurimi i shërbimit të transportit për mirëadministrimin dhe shërbimet për institucionet arsimore	Çdo vit	DPAP		400,000 lekë (bashkia)	Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi.

Objektivi 1.2 Të planifikojë ndërtimin, rregullimin dhe rehabilitimin e institucioneve të arsimit, duke siguruar ofrimin e një infrastrukture bashkëkohore për të plotësuar nevojat dhe interesat e fëmijëve dhe nxënësve të bashkisë së Elbasanit.

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Ndërtimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e institucioneve të arsimit parashkollor Rikonstruksione në kopshte (parashikimi për 12 objekte) Shtim i kopshteve me drekë (parashikimi për 2 institucione) Për arsimin bazë: Riparime, lyrje, rikonstruksion i objekteve arsimore parashikuar për 10 objekte. Rikonstruksion i plotë i shkollave: “N.Frashëri” dhe “Shushicë” Për arsimin e mesëm: Riparime, lyrje, rikonstruksion etj. Rikonstruksion i plotë i shkollës “Dhaskal Todri”.	2025 – 2028 2026 - 2028	DPAP DF	Shkollat, kopshtet	Qeveria shqiptare Buxhet vendor (9.000,000 lekë), transfertë e pakushtëzuar 10.000,000 lekë 13.000,000 lekë 26.000,000 lekë 49.000,000 lekë	Të dhëna për nr. ndërhyrjeve të realizuara në institucione (ndërtime, rikonstruksione, rehabilitime, lyrje, dezinfektim, mirëmbajtje kaldajash, pajisjesh elektrike, pajisje teknologjike, pajisje zyrtare, kthim i kopshteve pa drekë në kopshte me drekë)
	Hartimi dhe zbatimi i një plani vjetor për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore së institucioneve arsimore të bashkisë Elbasan dhe realizimi i projekteve të rehabilitimit për shkollat me probleme fizike dhe teknike.	2026	Drejtoria e buxhetit, Drejtoria e finances Drejtoria e projekteve, DPAP		Kostoja për këtë aktivitet nuk është përlogaritur në këtë fazë, pasi ndërhyrjet do të varen nga gjendja aktuale infrastrukturore e secilit institucion, si dhe nga mundësitë buxhetore dhe burimet e financimit të mundshëm. Një vlerësim teknik dhe financiar më i detajuar do	Dokumenti i planit vjetor i mirëmbajtjes së infrastrukturës

			ZVA		të realizohet gjatë hartimit të planit të mirëmbajtjes dhe investimeve.	
	Rajonizimi i institucioneve arsimore parauniversitare, me qëllim arsimimin në klasa normale dhe studim për rivlerësimin e ndarjes së cikleve arsimore në godina më vete.	2026 - 2028	DASHRSMD ZVA Drejtoria e transportit		Kostoja e saktë do të përcaktohet pas përfundimit të studimit	Studimi për rajonizimin e shkollave dhe ristrukturimin e tyre
	Mbeshtetja e klubeve mjedisore në shkolla (aty ku është mundësia) dhe organizimi i fushatave për mjedisin	2026 – 2028	DASHRSMD Shkollat	OJF mjedisore	Mbështetje donatorësh,	Nr. i klubeve të ngritura, aktiviteteve mjedisore

Objektivi 1.3 Të bashkëpunojë me institucionet e pushtetit qendror për realizimin e politikave të hartuara mbi arsimin si: paketat lehtësuese financiare; procesi i regjistrimit; identifikimi i fëmijëve në nevojë) dhe të vihet në funksion një sistem digjital për menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave të institucioneve arsimore.

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor, me qëllim frekuentimin e arsimit parashkollor	2 /vit	DASHRSMD	Grupet e interesit	120,000 lekë (bashkia)	Nr i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet
	Identifikimi i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që nuk e frekuentojnë kopshtin	Çdo vit	DASHRSMD	NJVKSH NJVNR	Marrëveshje institucionale	Të dhëna për nr e fëmijëve që nuk e frekuentojnë kopshtin
	Trajnime profesionale dhe kualifikuese në kuadër të arritjes dhe fuqizimit të standardeve të mësuesit parashkollor (hartimi i instrumentit të	2 /vit	DASHRSMD	UE	Marrëveshje institucionale 150,000 lekë (bashkia)	Të dhëna për nr e mësuesve të trajnuar

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

	vlërësimi të performancës për çdo punonjës të arsimit parashkollor).					
	Trajnimi i mësuesve për edukimin e ndjeshëm gjinor dhe mbrojtjen e fëmijëve vajza e djem nga dhuna dhe abuzimi	2 /vit	DASHRSMD NJMF		Burimet njerëzore të bashkisë	Të dhëna për nr e mësuesve të trajnuar
	Procesi i regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore sipas vendbanimit (krijimi i databazës elektronike)	2025-2028	DASHRSMD		Burimet njerëzore të bashkisë	Databzë elektronike me të dhënat për regjistrimin dhe frekuentimin e fëmijëve
	Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve në rrezik largimi nga arsimi i mesëm, përmes mentorimit, mbështetjes psikologjike dhe ekonomike.	2025-2028	DASHRSMD NJMF ASHS		Buxheti vendor	Të dhëna për nr e nxnësve të mentoruar
	Seminare me prindër për zhvillimin e qëndrueshëm emocional të fëmijëve	2025–2028	DASHRSMD NJMF	Psikologë, pedagogë	OJF, Marrëveshje institucionale,	Të dhëna për nr e seminareve të kryera dhe nr. e prindërve të përfshirë

Qëllimi 2 (Q2) – Menaxhim efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksionale për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies

Objektivi 2.1 Të përmirësojë cilësinë e shërbimit në arsimin parashkollor, duke krijuar kushtet e përshtatshme fizike dhe arsimore përmes menaxhimit të kurrikulës dhe kapaciteteve njerëzore, forcimit të shërbimit psiko-social dhe shërbimin e logopedit për fëmijët me nevoja ndryshe.

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Përfshirja dhe angazhimi i logopedëve (2 logopedë) në institucionet e arsimit parashkollor që kanë fëmijë me aftësi ndryshe dhe fuqizimi i shërbimit psiko-social në kopshte (2 psikologë)	2025-2028	DASHRSMD	Drejtoria e Shëndetit Publik, UE	Marrëveshje institucionale 14,400.000 leke	Të dhëna për përmirësimin e shërbimit psiko-social dhe logopedë
	Trajnime për staf edukativ për metodologji gjithëpërfshirëse dhe gjuhën e shenjave	2025 – 2028	DASHRSMD	UE, MASR	Marëveshje institucionale	Nr. i punonjësve të trajnuar

Objektivi 2.2 Të sigurohet aspekti gjithëpërfshirës i shkollimit të detyrueshëm për çdo fëmijë, duke iu përgjigjur sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor e të mesëm të ulët dhe mbështetje për aftësinë e kufizuar përmes transformimit të shkollës speciale në qendër burimore.

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Bashkëpunimi me institucionet arsimore për ndjekjen e fëmijëve jashtë sistemit shkollor.	2025-2028	DASHRSMD NJMF ZVA		Marrëveshje institucionale	Korrespondenca me institucionet arsimore për ndjekjen e fëmijëve jashtë sistemit shkollor.

	Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për rëndësinë e arsimit dhe luftimin e braktisjes shkollore. (3 fushata)	Çdo vit	DASHRSMD NJMF ZVA		Burimet njerëzore të bashkisë Marrëveshje institucionale	Takime me komunitetin dhe prindër.
	2.2.4 Mbështetje për transformimin e shkollës speciale në qendër burimore (projekt teknik + investim fillestar)		Drejtoria e projekteve		Me përfundimin e planit do të bëhet dhe përllogaritja financiare	

Objektivi 2.3 Të rritet përfshirja e fëmijëve nga grupet vulnerabël (romë, egjiptianë, me aftësi ndryshe, etj.), duke respektuar parimin e barazisë dhe diversitetit, si dhe të mundësohet mbështetje financiare nëpërmjet programit të bursave për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabël, me qëllim përfshirjen e tyre në arsim, sidomos edhe në arsimin e mesëm.

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Planifikimi i paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë përfshirjeje, duke mundësuar lehtësira financiare për përballimin e frekuentimit në kopshtet me ushqim. (52 fëmijë nga pakicat romë dhe 31 fëmijë nga grupet vulnerabël)	2025-2028	DASHRSMD		Buxhet vendor 6.600,000 lek	Kategoria e fëmijëve që përfitojnë përmes paketave financiare
	Hartimi i planit financiar mbështetës për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë, pakicave romë e egjiptiane dhe fëmijëve me aftësi ndryshe.	Çdo vit	DASHRSMD Drejtoria e buxhetit ZVA		Me përfundimin e planit do të bëhet dhe përllogaritja financiare	Plani financiar

Objektivi 2.4 Të forcohet bashkëpunimi me komunitetin, duke i përfshirë në procesin arsimor përmes forumeve dhe këshillave të shkollës, partneriteti me organizata joqeveritare dhe sektorin privat për mbështetjen e arsimit, si dhe të krijohet një sistem lokal monitorimi dhe raportimi për ecurinë e shkollave

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Bashkëpunimi me strukturat komunitare këshilluese (prindër, nxënës, komunitet) pranë shkollave dhe Këshillin Vendor të Arsimit Parauniversitar ⁶ për vendimmarrje dhe mbështetje vendore	Çdo vit	DASHRSMD ZVA		Marrëveshje institucionale	Krijimi i modelit të bashkëmenaxhimit me komunitetin shkollor për mirëmbajtjen e godinave.
	Fuqizimi i komuniteteve lokale për të marrë pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shkollave	Çdo vit	DASHRSMD Këshilli i Qarkut ZVA		Marrëveshje institucionale 240,000 leke	Krijimi i forumeve të rregullta me prindër, mësues dhe nxënës për vendimmarrje pjesëmarrëse.

Objektivi 2.5 Të zgjerohet përfshirja në arsimin profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës lokal dhe rajonal, duke nxitur bashkëpunimin mes shkollave profesionale dhe bizneseve për të zhvilluar module duale të praktikës profesionale.

Nr .	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Mbeshtetje për fushata për ndërgjegjësimin e të rinjve mbi përfitimet e formimit profesional.	2025 – 2028	DASHRSMD	SHPE, AKPA, QFP	Marrëveshje institucionale	Nr. i nxënësve që ndjekin arsimin profesional
	Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore,	2025 – 2028	DASHRSMD ZVAP	Administrator të Njësisë Administrative Shkollat;	Burime njerëzore të bashkisë	Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive

⁶ Këshilli Vendor i Arsimit Parauniversitar është organi këshillimor në nivel qarku

	përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.			Kopshtet; Prindërit		Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave
	Mbështetja e nxënësve të arsimit të profesional me rezultate të shkëlqyera	2026 – 2028	DASHRSMD ZVA	MAS, mësues, komuniteti	Transferte specifike	Nr. i nxënësve me rezultate të shkëlqyera të mbështetur

Objektivi 2.6 Të krijohen kushte të përshtatshme infrastrukturore për garantimin e akomodimit të nxënësve që vijnë nga larg dhe ndjekin arsimin profesional.

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	2.6.1 Planifikimi për mbështetje financiare për nxënësit nga zonat rurale apo larg institucionit arsimor	2025 - 2028	Drejtoria e buxhetit DPAP		Buxheti vendor Transferte specifike	Të dhëna për nr e nxënësve përfitues

Qëllimi 3 (Q3)– Mbështetja përmes veprimtarive jashtëshkollore, që nxisin zhvillimin social dhe kulturor për të garantuar sistem arsimor të drejtë dhe të cilësisë së lartë për të gjithë fëmijët e nxënësit.

Objektivi 3.1 Të fuqizohet i rrjetit të shkollave Qendër Komunitare, duke siguruar projekte dhe bashkëpunime konkrete në kuadër të arsimit dhe edukimit gjithëpërfshirës.

Nr.	Aktivitete	Afati	Përgjegjës	Partnerë	Kosto totale (lekë)	Treguesit matës
	Mbështetja për organizimin e klubeve shkollore dhe aktiviteteve sportive ose artistike, për të rritur motivimin dhe përfshirjen e nxënësve në kuadër	Çdo vit,	Shkollat QKF NJMF	Prindër, OJF, MAS	Buxhet vendor, Mbështetje donatorësh	Aktivitetet në numër dhe lloj përfshirjeje gjithëpërfshirëse; Kalendarit të aktiviteteve

	të rrjetit të shkollave si qendër komunitare.					
	Takime dhe këshillime/ sesione mbi prindërimin pozitiv në qendra komunitare me fokus të veçantë zonat rurale	4 herë/vit	NJMF	Prindër, OJF	240,000lekë	Veprimtaritë e kryera
	Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere me nxënës/nxënës, të rejtat / të rinjtë dhe komunitetin në tërësi, sidomos në zonat rurale, përgjatë gjithë vitit, mbi format e ndryshme të DHBGJ (përfshirë dhunën kibernetike, femicidin, trafikimin e qenieve njerëzore, martesat e hershme, etj)	Çdo vit	NJMF	Prindër, OJF	Burime njerëzore të bashkisë	Takimet informuese
	Angazhimi i fëmijëve të familjeve ku ushtrohet dhunë, në aktivitete sportive, artistike e kulturore, si mundësi për të trajtuar stresin dhe traumën e shkaktuar nga dhuna	Çdo vit	NJMF	Prindër, OJF	Burime njerëzore të bashkisë	Aktivitete të kryera Sipas kalendarit të aktiviteteve
	Organizimi i konkurseve në nivel lokal për lëndët kryesore (gjuhë shqipe, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi etj).	Çdo vit	QKF	ZVA		Aktivitetet e kryera
	Partneriteti me OJF vendase apo të huaja si: Save the Children, IPSED, CRCA etj, por edhe bashkëpunimi me sektorët e tjerë në bashki	Çdo vit	Drejtoria e projekteve	Save the Children, IPSED, CRCA	Donatorë	Sipas kalendarit të aktiviteteve të projekteve zbatuese nga OJF-të

7. Përmbledhje e investimeve kapitale

Investimet kapitale përbëjnë një shtyllë të rëndësishme në realizimin e objektivave strategjike të Planit të Arsimit Parauniversitar të bashkisë Elbasan. Këto investime synojnë përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, rritjen e cilësisë së mjedisit mësimor dhe zgjerimin e aksesit në arsim për të gjithë nxënësit. Gjatë periudhës së zbatimit të këtij plani, prioritet do t'i jepet:

- Ndërtimit, rikonstruksionit të plotë ose rehabilitimit të institucioneve arsimore ekzistuese, me qëllim përmirësimin e kushteve të higjienës, sigurisë dhe mjedisit fizik të nxënësit.
- Investimeve në pajisje dhe materiale didaktike bashkëkohore, për të përmirësuar cilësinë e procesit mësimor, përfshirë teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK), kabinete mësimore, laboratorë, mjete për arsimin gjithëpërfshirës etj.
- Përshtatjen e infrastrukturës për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke garantuar akses të barabartë në arsim për çdo fëmijë, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këto investime janë të lidhura ngushtësisht me objektivat strategjike të bashkisë Elbasan për të rritur:

- Cilësinë e ofrimit të shërbimeve arsimore;
- Barazinë në akses për të gjithë nxënësit;
- Aftësinë e sistemit për t'iu përgjigjur kërkesave të zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik të territorit.

Analizë e investimeve në godinat shkollore

Arsimi parashkollor: Bashkia Elbasan ka realizuar për vitin 2024 riparime dhe lyroje në 15 objekte me fondin e parashikuar në buxhetin e vitit 2024 me vlerë 3.440,000 lekë, ndërsa për rikonstruksionin e objekteve arsimore për vitin 2023-2024 janë bërë ndërhyrje në 9 objekte me vlerë 8.800,000 lekë. Për vitin 2024 në 18 objekte arsimore janë bërë rikonstruksione të llojit: riparime, merimetime dhe hidroizolime. Për vitin 2024 u parashikua në buxhet fondi prej 3.200,000 lekë për ushqime të 52 fëmijë të pakicave romë dhe 31 fëmijë vulnerabël të shpërndarë në institucionet e arsimit parashkollor të qytetit.

Arsimi bazë: Për vitin 2024 janë bërë riparime dhe lyroje në 25 objekte me fondin e parashikuar në buxhetin e bashkisë me vlerë 4.500,000 lekë, ndërsa për rikonstruksionin e objekteve arsimore për vitin 2024 është bërë ndërhyrje në 6 objekte me vlerë 4.150,000, lekë.

Arsimi i mesëm: Për vitin 2024 janë bërë riparime dhe lyroje në 11 objekte me fondin e parashikuar në buxhet me vlerë 2.380,000 lekë, ndërsa për rikonstruksionin e objekteve arsimore është bërë ndërhyrje në 5 objekte me vlerë 2.600,000, lekë.

Projektet e planifikuara për ndërtimin, rikonstruksionin ose zgjerimin e institucioneve arsimore, rehabilitimin e institucioneve arsimore apo projekteve të tjera, që mbulojnë në fushën e arsimit parauniversitar janë si më poshtë:

- Për vitin 2025 në 10 objekte arsimore do të bëhen rikonstruksione të pjesshme (riparime, merimetime, punime K.U.Z dhe hidroizolime).
- Rikonstruksion i objekteve arsimore parashikuar për vitet 2026- 2028 është 9.000,000 lekë dhe janë parashikuar 12 objekte arsimore (arsimi parashkollor).
- Në kuadër të planifikimeve për ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës fizike të institucioneve të arsimit të mesëm, janë parashikuar për periudhën 2025-2028 nga bashkia Elbasan 282,285 (mijë lekë).
- Janë parashikuar për vitin 2026-2028 kthimi dy kopshteve pa ushqim në kopshte me ushqim.
- Për vitin 2026-2028 parashikohet që fondi për mbështetjen e fëmijëve të pakicave rome dhe grupeve vulnerabël në kopshtet me ushqim të jetë në vlerën prej 6.600,000 lekë.
- Riparime dhe lryje për arsimin bazë janë parashikuar 10.000,000 lekë. Rikonstruksion i objekteve arsimore bazë janë parashikuar për vitet 2026- 2028 rreth 10 objekte me vlerë 13.000,000 lekë.
- Për vitin 2025 në 3 objekte arsimore do të kryhen rikonstruksione të plota (Gjimnazi “Dhaskal Todri”, shkolla 9- vjeçare “Naim Frashëri” dhe shkolla 9- vjeçare “Shushicë”).
- Riparime dhe lryje janë parashikuar 26.000,000 lekë, ndërsa rikonstruksion i objekte arsimore është parashikuar për vitet 2026-2028 afro 49.000,000 lekë.

8. Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar në bashkinë e Elbasanit do të realizohet sipas metodologjisë së konfirmuar nga njësia përgjegjëse në Kryeministri në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPSI/IPSIS)”, i cili, ndër të tjera, është sistemi kryesor për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuara në dokumentet strategjike.

Monitorimi duhet kuptuar si proces pune që synon të sigurojë informacion për bashkinë Elbasan dhe palët e interesuara për progresin drejt arritjes së objektivave specifike. Ai do të bazohet në një sistem të mbledhjes së informacionit dhe analizës së treguesve të monitorimit.

Monitorimi për Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar në bashkinë Elbasan nënkupton mbledhjen në vazhdimësi të të dhënave në lidhje me strategjinë e hartuar, si të atyre statistikore, ashtu edhe të dhënave të tjera që japin informacion për zbatimin e strategjisë. Për secilin aktivitet është përcaktuar përgjegjësia për mbledhjen e të dhënave, ndërsa roli mbikëqyrës dhe koordinues i takon drejtorive DASHRSMD dhe DPKSARS të bashkisë Elbasan. Raportimet mbi aktivitetet do të jenë periodike (çdo 3 muaj) ose në bazë të kërkesës së drejtorive përkatëse që janë angazhuar për planifikimin në nivel bashkie, apo Kabinetit të Kryetarit. Raportimet në bazë të objektivave të përgjithshme ose masave strategjike për mundësitë e përmirësimit të situatës do të përgatiten dy herë në vit (çdo 6 muaj).

Plani i Arsimit Parauniversitar përmban masa që avancojnë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në fushën e arsimit, të cilat mund të shfrytëzohen për qëllime monitorimi. Për shembull, krijimi i databzës elektronike për arsimin parauniversitar me treguesit e nevojshëm, do të krijojë mundësinë që të sigurohen të dhëna të nevojshme për monitorimin e progresit të planifikimit.

Vlerësimi

Vlerësimi është procesi më i hollësishëm i analizës së suksesit në zbatimin të Planit të arsimit Parauniversitar të bashkisë Elbasan, duke identifikuar se çfarë ka shkuar mirë, duke shqyrtuar arsyet se çfarë nuk ka shkuar mirë dhe pastaj duke ripërshtatur planifikimin në varësi të rrethanave. Vlerësimi përfshin përpilimin e pyetjeve të vlerësimit në formatin e pyetësorëve ose anketimeve, mbledhjen dhe analizën e të dhënave që u japin përgjigje këtyre pyetjeve, si dhe mbledhjen e provave për të formuluar përfundimet dhe rekomandimet.

Progresi i Planit të Arsimit Parauniversitar në bashkinë e Elbasanit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të përfshira në planifikimin buxhetor dhe vendimmarrjen institucionale.

Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Informacione periodike
- Treguesit e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe aksesshmërinë;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Vlerësimi i zbatimit të Planit Vendor të arsimit Parauniversitar do të bëhet në kuadër të procesit të vlerësimit vjetor të performancës së drejtorive që janë të angazhuara për zbatimin e këtij plani. Monitorimi dhe vlerësimi i planifikimit do të ndihmojë në analizën e progresit, arritjeve dhe sfidave dhe dakordësimin mbi prioritetet gjatë periudhës së mbetur të zbatimit të Plani i arsimit Parauniversitar.

Indikatorët e performancës:

Bashkia Elbasan, përmes zbatimit të Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar do të synojë të zhvillojë sistemin e vlerësimit dhe monitorimit. Përmes bashkëpunimit me Zyrën Arsimore Vendore Elbasan dhe Shkollën Profesionale Elbasan do të mundësojmë:

- Krijimi i një platforme lokale digjitale për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi performancën e institucioneve arsimore.
- Hartimi i regjistrit elektronik lokal të nxënësve për të ndjekur regjistrimin dhe frekuentimin

- Vlerësimi periodik i cilësisë së arsimit përmes anketimeve të nxënësit dhe mësuesit.
- Hartimi i një raporti vjetor për arritjet dhe sfidat në arsimin e mesëm në nivel bashkie

Tregues të tjerë të nevojshëm:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i hapësirave rekreative të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Tregues për cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe pjesëmarrjen e nxënësve;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Efikasiteti në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse

Planifikimi i vlerësimit të progresit:

Për të siguruar zbatimin efektiv të Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar në bashkinë Elbasan dhe për të monitoruar ndikimin e tij në zhvillimin arsimor lokal, është thelbësore vendosja e mekanizmave të qartë dhe të qëndrueshëm për vlerësimin periodik të progresit.

Këta mekanizma duhet të përfshijnë:

- Analizën e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara,
- Matjen e ndikimit të aktiviteteve në cilësinë e arsimit,
- Identifikimin e mangësive apo praktikave të suksesshme që duhen përforcuar.

Vlerësimi duhet të mbështetet në tregues të matshëm si përmirësimi i eficiencës së shërbimeve arsimore, përmirësimi i kushteve të infrastrukturës shkollore, rritja e pjesëmarrjes në arsim profesional apo përfshirja më e madhe e komunitetit në proceset arsimore. Bashkia Elbasan (drejtoritë përgjegjëse) nëpërmjet instrumenteve konkrete si: raportet periodike, raportet vjetore të monitorimit, anketat me aktorët lokalë dhe auditimet periodike synon përmirësimin e vazhdueshëm të politikave arsimore në funksion të nevojave të komunitetit dhe zhvillimeve lokale.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm:

Për të garantuar një vlerësim objektiv dhe gjithëpërfshirës të zbatimit të Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar në nivel bashkiak është e domosdoshme përfshirja e aktorëve të jashtëm në procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Konsultimi me ekspertë të fushës së arsimit, përfaqësues të institucioneve akademike, organizata joqeveritare, si dhe institucione kombëtare e ndërkombëtare që merren me zhvillimin arsimor, ndihmojnë në sigurimin e vlerësimeve të pavarura dhe rekomandimeve të specializuara.

Grupi i punës zhvilloi konsultime me përfaqësues nga Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare Elbasan, Shkolla Profesionale Elbasan, Këshilli bashkiak Elbasan, organizata “Ëëoman Center for Development and Culture Albania” dhe “Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome”, OGF, me qëllim përfshirjen e perspektivave të aktorëve të ndryshëm lokalë dhe për të pasuruar dokumentin me inpute të dobishme dhe të zbatueshme.

Kjo përfshirje mundëson një këndvështrim të jashtëm mbi ecurinë e planit, identifikon praktikën më të mira dhe ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të politikave arsimore në nivel lokal. Për më tepër, angazhimi i aktorëve të interesuar, si prindërit, komuniteti lokal dhe sektori privat, forcon llogaridhënien dhe rrit transparencën në procesin e zbatimit të planit strategjik për arsimin.

9. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Procesi i rishikimit

Për të siguruar që Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar në bashkinë Elbasan të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv në një mjedis dinamik social dhe arsimor, është e nevojshme të parashikohet një proces periodik rishikimi. Ky proces duhet të jetë i planifikuar në intervale të rregullta dhe të bazohet në të dhëna konkrete nga vlerësimet e progresit, rekomandimet e aktorëve të jashtëm dhe analizat e nevojave të reja që lindin në terren.

Raportimet mbi aktivitetet e planit mund të shtrihen:

- Rishikim çdo 3 muaj për ecurinë e aktiviteteve;
- Rishikim çdo 6 muaj për raportimet e objektivave strategjike
- Rishikimi vjetor - i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027) – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- Rishikime të jashtëzakonshme, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Rishikimi i planit duhet të përfshijë përditësimin e objektivave, rishikimin e prioriteteve, përshtatjen e aktiviteteve dhe ndarjen më të mirë të burimeve, duke e mundur atë një herë në vit. Pjesë e raportimit duhet të jetë dhe grupi hartues i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar, ekspertë të fushës dhe grupe interesi, të cilët mund të realizojnë rishikimin e efikasitetit të zbatimit të planit së paku një herë në vit. Ky mekanizëm i përshtatjes i jep planit një karakter fleksibël dhe siguron që ai të jetë gjithmonë në përputhje me realitetin lokal dhe sfidat që paraqiten gjatë zbatimit të tij.

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar në bashkinë Elbasan është i hapur për çdo ndryshim të mundshëm, që është në funksion të zbatimit të politikave të këtij dokumenti.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve:

Në funksion të një zbatimi sa më efektiv të Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar në bashkinë Elbasan, është thelbësore që masat dhe aktivitetet e parashikuara të jenë të adaptueshme ndaj realitetit në terren. Bazuar në të dhënat e mbledhura përmes proceseve të monitorimit dhe vlerësimit, do të kryhet rishikimi i vazhdueshëm i masave dhe aktiviteteve me qëllim adresimin e çdo vështirësie të hasur gjatë zbatimit. Kjo mund të përfshijë riformulimin e objektivave specifike, riorganizimin e burimeve njerëzore dhe financiare, ndryshimin e metodave të ndërhyrjes apo shtimin e komponentëve të rinj që lidhen me nevoja emergjente të komunitetit.

Aktivitete konkrete – përmirësim i përmbajtjes, afateve, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit; Alokimin e burimeve – kur nevojitet më shumë mbështetje për të arritur objektivat; Prioritetet vjetore – sipas nevojave emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit; Përshtatja e vazhdueshme ndihmon jo vetëm në rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve, por edhe në sigurimin e një qasjeje fleksibël dhe reaguese ndaj zhvillimeve të reja në fushën e arsimit në nivel lokal.

10. Raportimi dhe transparenca

Raportimi i progresit

Raportimi i rregullt i progresit është një komponent kyç për transparencën, llogaridhënien dhe ndjekjen efektive të zbatimit të planit të arsimit në nivel bashkiak. Duhet të përcaktohen qartë format, frekuenca dhe përgjegjësit për hartimin e raporteve periodike. Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria ose Sektori përgjegjës, konkretisht për zbatimin e aktivitetit tek Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Strategjike, Sociale, Shërbimeve Komunitare dhe Inovacionit dhe Kabineti i Kryetarit të bashkisë.

Përmes hartimit të raporteve tremujore, gjashtëmujore ose vjetore, të cilat do të përmbajnë informacion të detajuar mbi ecurinë e realizimit të objektivave strategjike, aktivitetet e kryera, sfidat e hasura gjatë zbatimit si dhe masat korrigjuese të ndërmarra, do të jepet mundësia për transparencën e kryerjes së planifikimit. Këto raporte do t'u shërbejnë strukturave drejtuese të bashkisë, institucioneve arsimore, komunitetit dhe aktorëve të tjerë të interesuar për të pasur një pasqyrë të qartë mbi ecurinë e planit dhe për të marrë vendime të bazuara në të dhëna. Gjithashtu, publikimi i përmbledhjeve të raporteve për publikun ndihmon në rritjen e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në çështjet e arsimit.

Përfshirja e publikut:

Për të garantuar një proces të hapur dhe gjithëpërfshirës në zbatimin e Planit të Arsimit Parauniversitar në bashkinë Elbasan, duhet të sigurohet transparenca përmes publikimit të rezultateve dhe ecurisë së zbatimit të tij. Rezultatet kryesore, sfidat e evidentuara dhe masat e marra do të bëhen të aksesueshme për publikun nëpërmjet kanaleve zyrtare të bashkisë, si faqja e internetit, rrjetet sociale dhe mbledhje informuese me komunitetin. Përveç informimit, është thelbësore të krijohen hapësira për konsultime publike, ku qytetarët, prindërit, mësuesit, nxënësit dhe aktorë të tjerë të interesuar të kenë mundësinë të japin mendimet, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre mbi ecurinë e planit. Këto konsultime do të

organizohen në formën e tryezave të rrumbullakëta, forumeve komunitare apo sondazheve online, duke ndihmuar në përmirësimin e mëtejshëm të politikave arsimore dhe rritjen e ndjesisë së përkatësisë dhe bashkëpërgjegjësisë së qytetarëve ndaj zhvillimit të arsimit në komunitetin e tyre.

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

Anekse

Të dhëna demografike dhe statistikore

Tabela.1 Nr. i popullsisë dhe familjeve në vitet 2015 –2024 (gjendja me 31.12. të çdo viti)

	Lagja	2015		2016		2017		2018		2019		2020		2021		2022		2023		2024	
Nr.	Njesia	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.	Nr. Familj	Nr. Popull.
	Admin.																				
1	Lagja Nr. 1	6754	22356	7360	22620	7504	22781	7545	22804	7834	23145	7916	23238	7829	23053	7830	23445	8233	23577	8.348	23.69
2	Lagja Nr. 2	6894	23025	7513	23069	7654	23106	7712	23219	7909	23296	7965	23261	7877	23076	7879	23299	8269	23378	8.323	23.386
3	Lagja Nr.3	7798	26388	8498	26750	8854	27436	8926	27518	9270	27936	9363	28043	9260	27818	9263	28361	9797	28563	9.92	28.758
4	Lagja Nr.4	6752	22045	7358	22205	7432	22024	7477	22072	7715	22164	7780	22180	7694	22009	7696	22219	8078	22320	8.168	22.361
5	Lagja Nr.5	4360	13150	4400	13180	4405	13190	4410	13201	4420	13538	4490	13721	4441	13616	4443	13820	4767	14043	4847	14021
6	Lagja Nr.6	5242	20556	6066	20709	6378	21050	6472	21088	6923	21266	7351	21306	7270	21143	7272	21689	7302	21756	7348	21778
A.	Sh. Qytetit	37800	127520	41195	128533	42227	129587	42542	129902	44071	131345	44865	131749	44371	130715	44383	132833	46446	133637	46.954	134.06
1	Bradash	3525	13055	3620	12841	3896	13053	3828	13554	4049	13666	3990	13732	3947	13628	3951	13778	4211	13819	4972	16.225
2	Graceni	673	2485	690	2483	702	2408	700	2410	720	2472	699	2340	691	2323	692	2335	701	2340	680	2359
3	Gjinari	1439	5054	1542	5002	1516	5003	1568	5005	1620	5001	1622	4892	1604	4856	1601	4709	1671	4701	1708	4674
4	Zavalina	598	1805	610	1819	639	1869	605	1541	617	1425	616	1422	609	1413	608	1415	608	1380	605	1350
5	Shushica	2963	11164	3069	11225	3175	11422	3194	11429	3371	11613	3438	11667	3400	11579	3403	11797	3632	11861	3689	11963
6	Shirgjan	2822	10408	3026	10517	3139	10651	3165	10661	3262	10829	3298	10896	3262	10814	3264	11046	3516	11081	3596	11162
7	Paper	2424	9211	2553	9281	2684	9340	2709	9355	2816	9409	2826	9444	2796	9373	2798	9477	2877	9513	2892	9548
8	Gjergjan	2162	7881	2270	7944	2346	7983	2368	7988	2440	8076	2455	8136	2429	8075	2431	8276	2567	8331	2589	8377
9	L-Fushe	1758	6681	1869	6725	2006	6933	2028	6931	2117	6999	2175	7040	2151	6987	2152	7155	2319	7202	2342	7.258
10	L-Mal	1642	5691	1704	5707	1710	5803	1714	5627	1748	5595	1777	5617	1757	5576	1757	5680	1952	5666	1987	5.631
11	Tregan	1229	4555	1282	4569	1305	4561	1326	4492	1383	4578	1389	4602	1373	4568	1374	4633	1484	4661	1523	4674
12	Funar	1006	3071	1025	3044	1014	2867	1023	2874	1041	2856	1044	2824	1032	2804	1031	2752	1041	2712	1037	2685
B.	Sh. Nj. Adm.	22241	81061	23260	81157	24132	81893	24228	81867	25184	82519	25329	82612	25051	81996	25062	83053	26579	83267	26940	83520
A+	TOTALI	60041	208581	64455	209690	66359	211480	66770	211769	69255	213864	70194	214361	69422	212711	69445	215886	73025	216904	73894	217578
B																					

Tabela 1. Projektionet demografike për vitet 2019 dhe 2031

Grup-mosha	Skenari i rritjes së ulët		Skenari i rritjes së mesme		Skenari i rritjes së lartë	
	2019	2031	2019	2031	2019	2031
0-5	189,482	139,425	189,482	177,822	189,482	220,884
6-14	303,942	229,289	303,942	256,250	303,942	286,323
15-17	117,562	89,882	117,562	92,285	117,562	95,161
18-24	326,612	198,442	326,612	206,577	326,612	216,216
< 25 vjeç	937,598	657,038	937,598	732,934	937,598	818,584
15-64	1,965,787	1,646,671	1,965,787	1,712,808	1,965,787	1,793,968
65+	403,216	577,585	403,216	599,110	403,216	621,572
Të gjithë	2,862,427	2,592,970	2,862,427	2,745,990	2,862,427	2,922,747

(Burimi: Baza e të dhënave statistikore, INSTAT, shkurt 2020)

Tabela.2 Shpërndarja e kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale në Elbasan

Nr	Njësia Administrative	Kopshte godina me vete	Kopshte brenda godinave te shkollave	Shkolla te arsimit baze (fillore + 9vjecare)	Shkolla të mesme të përgjithshme	Shkolla te mesme te bashkuara	Shkolla profesionale	Objekte Arsimore
1	Lagja Nr.1	3	3	2	-	1	-	6
2	LagjaNr. 2	5	4	3	2	1	-	11
3	Lagja Nr.3	3	4	4	2	-	1	10
4	Lagja Nr.4	3	2	3	-	-	-	6
5	Lagja Nr.5	2	2	4	2	-	-	8
6	Lagja Nr.6	3	1	2	-	-	-	5
7	Bradashesh	2	7	7	-	-	-	9
8	Gracen	-	4	5	-	-	-	5
9	Gjinar	-	5	7	-	1	-	8
10	Zavaline	-	1	1	-	1	-	2
11	Shushice	1	6	7	-	-	-	8
12	Shirgjan	1	4	5	1	-	-	7
13	Paper	5	5	6	-	1	-	12
14	Gjergjan	-	5	5	-	-	-	5
15	Labinot-Fushe	1	7	6	-	1	-	8
16	Labinot-Mal	1	7	8	-	2	-	11
17	Tregan	-	7	7	-	-	-	7
18	Funar	-	2	5	-	1	-	6
Total Bashkia Ebasan		30	76	87	7	9	1	134

Tabela nr.3 Të dhëna statistikore mbi arsimin parashkollor.

Nr.	Kopshti	Emri i Njesise Lokale	Me ushqim / Pa ushqim	Kapaciteti	Gjithsej grupe	Gjithsej femije	Femije me aftesi e kufizuar / Mendore	Femije me aftesi e kufizuar / Fizike	Femije Rom	Femije Egjiptian
1	Kopshti 1	Elbasan	Me Ushqim	140	4	142	2	1		9
2	Kopshti 2	Elbasan	Me Ushqim	120	4	110	3			13
3	Kopshti 3	Elbasan	Pa Ushqim	100	4	49				7
4	Kopshti 4	Elbasan	Pa Ushqim	100	6	101	1	1	7	45
5	Kopshti 5	Elbasan	Me Ushqim	150	4	123				2
6	Kopshti 6	Elbasan	Me Ushqim	90	4	95			2	5
7	Kopshti 7	Elbasan	Me Ushqim	106	4	117			4	9
8	Kopshti 8	Elbasan	Me Ushqim	100	4	74	7			12
9	Kopshti 9	Elbasan	Me Ushqim	110	4	151				5
10	Kopshti 10	Elbasan	Pa Ushqim	120	4	73	2		4	3
11	Kopshti 11	Elbasan	Pa Ushqim	200	10	233	2	1	50	16
12	Kopshti 12	Elbasan	Me Ushqim	130	4	127				11
13	Kopshti 13-14	Elbasan	Pa Ushqim	100	5	49	9	1		14
14	Kopshti 15	Elbasan	Pa Ushqim	150	4	78	5		1	27
15	Kopshti 16	Elbasan	Pa Ushqim	110	4	58	1	1		13
16	Kopshti 17	Elbasan	Pa Ushqim	150	6	123	2		1	5
17	Fadil Gurmani	Elbasan	Pa Ushqim	30	1	17				1
18	Fejzullah Guranjaku	Elbasan	Pa Ushqim	30	1	4	1			2
19	Ali Agjah	Elbasan	Pa ushqim	25	1	32				
20	Jorgji Dilo	Elbasan	Pa Ushqim	35	1	33				
21	Luigj Gurakuqi	Elbasan	Pa Ushqim	56	2	38				2
22	Bardhyl Popa	Elbasan	Pa Ushqim	30	2	44				
23	Sule Domi	Elbasan	Pa Ushqim	30	1	25				
24	Naim Frasheri	Elbasan	Pa Ushqim	31	1	23				

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

25	Qemal Haxhihasani 2	Elbasan	Pa Ushqim	100	1	18	1	3	5
26	Onufri	Elbasan	Pa Ushqim	100	1	17			3
27	Sule Misiri	Elbasan	Pa Ushqim	30	1	17			14
28	Bradashesh	Bradashesh	Pa Ushqim	78	4	50			18
29	Karakullak	Bradashesh	Pa Ushqim	15	1	14			
30	Myrteza Gjoni	Bradashesh	Pa Ushqim	25	1	16			
31	Balëz Lart	Bradashesh	Pa Ushqim	25	1	15			
32	Katund i Ri	Bradashesh	Pa Ushqim	100	4	58			4
33	Petresh	Bradashesh	Pa Ushqim	25	1	5			
34	Rrilë	Bradashesh	Pa Ushqim	20	1	11			
35	Kozan	Gracen	Pa Ushqim	13	1	8			
36	Kusarth	Bradashesh	Pa Ushqim	30	2	25			
37	Ali Sollaku	Gjergjan	Pa Ushqim	25	1	22			
38	Abdullah Sinani	Gjergjan	Pa Ushqim	20	1	15			
39	Spiro Sula	Gjergjan	Pa Ushqim	17	1	10			
40	Xhemal Jançe	Gjergjan	Pa Ushqim	24	2	31			
41	Lleshan	Gjinar	Pa Ushqim	20	1	10			
42	Kostandin Shpataraku	Gjinar	Pa Ushqim	15	1	5			
43	Pashtrash	Gjinar	Pa Ushqim	15	1	5			
44	Pobrat	Gjinar	Pa Ushqim	20	1	9			
45	Tërbaç	Gracen	Pa Ushqim	20	1	6			
46	Sulejman Rrançi	Labinot Fushë	Pa Ushqim	35	3	58			
47	Abdulla Keta	Labinot Fushë	Pa Ushqim	18	1	15			
48	Shegun	Labinot Fushë	Pa Ushqim	24	1	17			
49	Musa Bica	Labinot Fushë	Pa Ushqim	20	1	13			
50	Ramazan Bala	Labinot Fushë	Pa Ushqim	30	1	13			
51	Sali N.Ballkoçi	Labinot Fushë	Pa Ushqim	41	1	14			
52	Sericë	Labinot Mal	Pa Ushqim	15	1	16			
53	Papër	Papër	Pa Ushqim	20	1	15			3
54	Valas	Papër	Pa Ushqim	15	1	9			
55	Murras	Papër	Pa Ushqim	10	1	0			

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

56	Dervish Bahja	Papër	Pa Ushqim	20	1	5	
57	Seit Pepa	Papër	Pa Ushqim	20	1	15	
58	Balldren	Papër	Pa Ushqim	25	1	10	
59	Kryezjarrth	Shirgjan	Pa Ushqim	30	1	5	
60	Ismail Kasa	Shirgjan	Pa Ushqim	50	2	40	
61	Kuqan	Shirgjan	Pa Ushqim	30	2	27	5
62	Shirgjan	Shirgjan	Pa Ushqim	25	2	16	
63	Mjekës	Shirgjan	Pa Ushqim	25	1	6	
64	Bathës	Shirgjan	Pa Ushqim	30	1	5	
65	Mlizë	Shushicë	Pa Ushqim	44	2	35	2 11
66	Shushicë	Shushicë	Pa Ushqim	80	4	77	6
67	Hajdaran	Shushicë	Pa Ushqim	43	2	30	
68	Shelcan	Shushicë	Pa Ushqim	44	2	17	
69	Fushë Buall	Shushicë	Pa Ushqim	27	1	20	
70	Polis i Vogël	Shushicë	Pa Ushqim	18	1	6	
71	Jonuz Çarçiu	Tregan	Pa Ushqim	30	1	16	2
72	Shilbater	Tregan	Pa Ushqim	20	1	5	
73	Muçan	Tregan	Pa Ushqim	30	1	9	
74	Kodhel Dedja	Zavaline	Pa Ushqim	25	1	5	
75	Shijon	Bradashesh	Pa Ushqim	15	1	5	
76	Derstilë	Gjinar	Pa Ushqim	12	1	5	
77	Isuf Deliu	Funar	Pa Ushqim	25	1	21	
78	Ibrahim Çeka	Funar	Pa Ushqim	25	1	16	
79	Gjormë	Gracen	Pa Ushqim	30	1	14	
80	11 Dëshmorët	Labinot Mal	Pa Ushqim	50	2	34	
81	Griqan Lart	Labinot Fushë	Pa Ushqim	25	1	10	
82	Mamël	Gracen	Pa Ushqim	20	1	2	
83	Çikallesh	Tregan	Pa Ushqim	20	1	15	
84	Kaçivel	Tregan	Pa Ushqim	20	1	5	
85	Qerret	Labinot Mal	Pa Ushqim	20	1	10	
86	Ullishte	Papër	Pa Ushqim	15	1	12	1

87	Mallkas	Papër	Pa Ushqim	18	1	8
88	Gur i Zi	Labinot Mal	Pa Ushqim	20	1	12
89	Kodra Bujaras	Gjergjan	Pa Ushqim	28	1	9
90	Labinot Mal	Labinot Mal	Pa Ushqim	29	1	11
91	Ibrahim Bozhiqi	Labinot Mal	Pa Ushqim	50	1	4
92	Trepshenist	Tregan	Pa Ushqim	30	1	5
93	Paper-Sollak	Papër	Pa Ushqim	25	1	3
94	Budan	Labinot Mal	Pa Ushqim	28	1	8
95	Shinavlash	Tregan	Pa Ushqim	20	1	7
96	Lugaxhi	Labinot Mal	Pa Ushqim	20	1	5
97	Pajun	Papër	Pa Ushqim	20	1	7

Tabela nr.4 Të dhëna statistikore mbi arsimin bazë.

Nr	Emri i shkolles	Emri i Njesise Lokale	Lloji sipas ciklit	Nxenes klasa 1 - 9	Klasa kolektive	Nxenes te ardhur nga emigracioni	Nxenes me aftesi e kufizuar / mendore	Nxenes me aftesi e kufizuar / fizike	Nxenes Rom	Nxenes Egjiptian
1	Fadil Gurmani	Elbasan	9-vjecar	357	0	0	6		5	61
2	Adem Krasniqi	Elbasan	9-vjecar	155	0	1	2		0	20
3	Ali Agjahu	Elbasan	9-vjecar	450	0	3	2	1	0	22
4	Bardhyl Popa	Elbasan	9-vjecar	393	0	0	1		0	24
5	Fejzullah Guranjaku	Elbasan	9-vjecar	65	0	0	7		0	10
6	Hamit Mullisi	Elbasan	9-vjecar	112	0	1	2		69	5
7	Sulë Domi	Elbasan	Fillor	65	0	0			4	0
8	Jeronim De Rada	Elbasan	9-vjecar	369	0	0	6		0	46
9	Jorgji Dilo	Elbasan	9-vjecar	696	0	2	2	3	1	39
10	Luigj Gurakuqi	Elbasan	BM	623	0	0	4		4	23

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

11	Naim Frashëri	Elbasan	9-vjecar	679	0	1	2	1	9	
12	Onufri	Elbasan	BM	189	0	0	1	0	31	
13	Ptoleme Xhuvani	Elbasan	9-vjecar	171	0	5	7	7	105	
14	Ptoleme Xhuvani-Korespondenc	Elbasan	9-vjecar	53	53	0		2	21	
15	Qamil Guranjaku	Elbasan	9-vjecar	657	0	2	4	0	15	
16	Qemal Haxhihasani 1	Elbasan	Fillor	149	0	2	2	5	21	
17	Qemal Haxhihasani 2	Elbasan	Fillor	148	0	2	4	2	17	32
18	Sulë Misiri	Elbasan	9-vjecar	152	0	3	3	0	102	
19	Xhaferr Hakani	Elbasan	9-vjecar	208	0	1	4	2	42	
20	Abdyl Paralloi	Elbasan	9-vjecar	314	0	1	8	48	112	
21	Zëra Jete	Elbasan	9-vjecar	53	0	0	43	9	2	3
22	Sulë Harri	Elbasan	9-vjecar	603	0	0		1	0	5
23	Alush Lleshanaku	Bradashesh	9-vjecar	237	0	1	2	0	103	
24	Myrteza Gjoni	Bradashesh	9-vjecar	91	9	0	3	0	0	
25	Balëz Lart	Bradashesh	Fillor	22	0	0		0	0	
26	Katund I Ri	Bradashesh	9-vjecar	323	0	1	4	0	0	
27	Petresh	Bradashesh	9-vjecar	4	0	1		0	0	
28	Rrilë	Bradashesh	9-vjecar	33	33	0	2	0	0	
29	Kozan	Gracen	9-vjecar	32	32	0	0	0	0	
30	Kusarth	Bradashesh	9-vjecar	136	0	4	2	0	0	
31	Isuf Deliu	Funar	9-vjecar	34	34	0	1	0	0	
32	Krrabe e vogel	Funar	9-vjecar	2	0	0	1	0	0	
33	Mahmud Deliu	Funar	9-vjecar	15	15	0	1	0	0	
34	Ibrahim Çeka	Funar	BM	45	24	0		0	0	
35	Cërujë	Funar	9-vjecar	3	3	0	1	0	0	
36	Tërbaç	Gracen	9-vjecar	12	12	0		0	0	

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

37	Mamël	Gracen	9-vjecar	5	5	0		0	0
38	Plangaricë	Gracen	9-vjecar	7	7	0		0	0
39	Gjormë	Gracen	9-vjecar	72	41	1	1	0	0
40	Xhemal Jançe	Gjergjan	9-vjecar	122	0	0		0	0
41	Kodra Bujaras	Gjergjan	Fillor	5	5	0		0	0
42	Abdullah Sinani	Gjergjan	9-vjecar	36	30	0	1	0	0
43	Ali Sollaku	Gjergjan	9-vjecar	58	33	0	2	0	2
44	Spiro Sula	Gjergjan	9-vjecar	26	26	0		0	0
45	Kostandin Shpataraku	Gjinar	BM	40	20	0	1	0	0
46	Dërstilë	Gjinar	Fillor	16	16	0		0	0
47	Lleshan	Gjinar	9-vjecar	62	27	0		0	0
48	Valësh	Gjinar	9-vjecar	1	0	0		0	0
49	Pashtresh	Gjinar	9-vjecar	2	0	0		0	0
50	Pobrat	Gjinar	9-vjecar	45	21	0		0	0
51	Sali N.Ballkoçi	Labinot Fushë	BM	68	38	2	2	0	0
52	Ramazan Bala	Labinot Fushë	9-vjecar	47	27	0	3	0	0
53	Abdulla Keta	Labinot Fushë	9-vjecar	91	0	0		0	0
54	Shegun	Labinot Fushë	Fillor	25	11	0		0	0
55	Sulejman Rrançi	Labinot Fushë	9-vjecar	149	0	0	3	0	0
56	Musa Bica	Labinot Fushë	9-vjecar	80	28	0	1	0	6
57	Griqan Lart	Labinot Fushë	9-vjecar	38	32	0	1	0	0
58	11 Dëshmorët	Labinot Mal	BM	169	0	0		0	0
59	Ibrahim Bozhiqi	Labinot Mal	BM	60	22	0		0	1
60	Labinot Mal	Labinot Mal	Fillor	16	16	0		1	0
61	Budan	Labinot Mal	9-vjecar	26	26	0		0	0
62	Dalip Qoku	Labinot Mal	9-vjecar	18	18	0		0	0

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

63	Sericë	Labinot Mal	9-vjecar	51	26	0		0	0
64	Kronë	Labinot Mal	Fillor	4	4	0		0	0
65	Lamollë	Labinot Mal	Fillor	14	14	0		0	0
66	Guri Zi	Labinot Mal	9-vjecar	54	26	0	2	0	0
67	Qerret	Labinot Mal	9-vjecar	57	33	0		0	0
68	Fiqiri Baltëza	Papër	BM	115	0	2		0	9
69	Dervish Bahja	Papër	9-vjecar	40	40	0		0	0
70	Seit Pepa	Papër	9-vjecar	146	0	0	3	0	0
71	Balldren	Papër	Fillor	33	0	0	1	0	0
72	Pajun	Papër	9-vjecar	28	22	0	1	0	0
73	Papër Sallak	Papër	9-vjecar	16	16	0		0	0
74	Vidhas Hasgjel	Papër	Fillor	3	3	0		0	0
75	Kuqan	Shirgjan	9-vjecar	234	0	0	5	0	0
76	Shirgjan	Shirgjan	Fillor	15	9	0		0	0
77	Mjekës	Shirgjan	Fillor	11	6	0		0	0
78	Bathës	Shirgjan	Fillor	0	0	0		0	0
79	Ismail Kasa	Shirgjan	9-vjecar	194	0	0	2	0	0
80	Shushicë	Shushicë	9-vjecar	312	0	2	9	0	34
81	Shelcan	Shushicë	9-vjecar	58	32	0	1	0	19
82	Fushë Buall	Shushicë	9-vjecar	57	33	0	2	0	2
83	Hajdaran	Shushicë	9-vjecar	133	0	0		0	0
84	Polis Valë	Shushicë	9-vjecar	11	11	0		0	0
85	Polis I Vogël	Shushicë	9-vjecar	26	26	0		0	0
86	Mlizë	Shushicë	9-vjecar	123	0	3	5	0	35
87	Jonuz Çarçiu	Tregan	9-vjecar	119	0	0	1	0	0
88	Shilbatër	Tregan	9-vjecar	20	20	0		0	0

89	Muçan	Tregan	9-vjecar	26	26	0	2		0	0
90	Trepshishtë	Tregan	9-vjecar	26	26	0			0	0
91	Kaçivël	Tregan	9-vjecar	8	8	0			0	0
92	Shinavlash	Tregan	9-vjecar	19	19	0	2	1	0	0
93	Kodhël Dedja	Zavalinë	BM	34	34	0			0	0
94	Nezhan	Zavalinë	Fillor	0	0	0			0	0
95	Domush	Funar	Fillor	5	5	0	1		0	0
96	Çikallesh	Tregan	Fillor	8	6	0			0	0
97	Sterstan	Gjinar	Fillor	0	0	0			0	0

Tabela nr.5 Të dhëna statistikore për arsimin e mesëm.

Nr.	Shkolla	Emri i Njesisë Lokale	Lloji sipas programit	Specifikimi në varesi të llojit	E Bashkuar ose Jo	Nga klasa X-XIII	Maturantë	Nxenes ardhur nga emigracioni	Nxenes me aftësi e kufizuar /mendore	Nxenes me aftësi e kufizuar / fizike	Nxenes Rom	Nxenes Egjiptian
1	Ahmet Dakli	Elbasan	Gjimnaz	Klasike	E Veçantë	169	70	1	1			12
2	Luigj Gurakuqi	Elbasan	Gjimnaz	Klasike	MB	236	80				1	13
3	Luigj Gurakuqi	Elbasan	Gjimnaz	Bilinguale	MB	87	26		1		2	2
4	Mahmut & Ali Cungu	Elbasan	Social-kulturore	Gjuhe e Huaj	E Veçantë	82	33	2	1	1	1	8
5	Onufri	Elbasan	Social-kulturore	Artistike	MB	80	22		1			15
6	Kostandin Kristoforidhi	Elbasan	Gjimnaz	Klasike	E Veçantë	605	198				1	3
7	Dhaskal Todri	Elbasan	Gjimnaz	Klasike	E Veçantë	603	198			1		10
8	Vasil Kamami	Elbasan	Gjimnaz	Klasike	E Veçantë	124	42		4			10
9	Mahir Domi	Elbasan	Gjimnaz	Klasike	E Veçantë	177	55		3		1	2
10	Mahir Domi	Elbasan	Me kohe të shkurtuar	Natën	E Veçantë	811	200	22	44	279		35

PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025 – 2028

11	Anastas Çakalli	Shirgjan	Gjimnaz	Klasike	E Veçantë	85	34	1	1
12	11 Dëshmorët	Labinot Mal	Gjimnaz	Klasike	MB	58	17		
13	Ibrahim Çeka	Funar	Gjimnaz	Klasike	MB	26	9		2
14	Sali N.Ballkoçi	Labinot Fushë	Gjimnaz	Klasike	MB	38	11		1
15	Ibrahim Bozhiq	Labinot Mal	Gjimnaz	Klasike	MB	48	19		
16	Fiqiri Baltëza	Papër	Gjimnaz	Klasike	MB	18	9	2	2
17	Kostandin Shpataraku	Gjinar	Gjimnaz	Klasike	MB	40	17	1	
18	Kodhel Dedja	Zavalinë	Gjimnaz	Klasike	MB	17	3		1

Kuadri ligjor dhe rregullativ

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë – neni 57, pika 1
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026
- Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025) & Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021 – 2026).
- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë":
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligji 115/2024, “Për Buxhetin e vitit 2025”.
- Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë“
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”; Kreu II, “Arsimi Parashkollor”
- Udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI Nr. 13, datë 10.07.2024 “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- Udhëzimi Nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”
- Udhëzimi Nr. 21, datë 08.08.2014 "Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë"
- Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025)
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.
- Udhëzimi Nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.
- Udhëzimi Nr. 42, datë 15.10.2015 “Për identifikimin e nevojave për zhvillimin profesional të punonjësve mësimorë në sistemin arsimor parauniversitar”.
- Udhëzimi Nr. 26, datë 15.8.2014 “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”.
- Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë
- Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.
- Standardet profesionale për formimin e përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor

Indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit

Lista e indikatorëve

- Të dhënat për regjistrimet, frekuentimin, buxhetin, planifikimin, investimet etj.
- Përqindjet e arritjeve të nxënësve,
- Instrumenti për cilësinë e mësimdhënies
- Platforme lokale digjitale për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi performancën e institucioneve arsimore.
- Hartimi i regjistrit elektronik lokal të nxënësve dhe punonjësve arsimorë
- Vlerësimi periodik i cilësisë së arsimit përmes anketimeve të nxënësit dhe mësuesit.
- Hartimi i një raporteve periodike dhe vjetore
- Tryeza diskutimesh e konsultimesh

Lista e aktorëve të përfshirë

- Bashkia Elbasan
- Këshilli bashkiak Elbasan
- Zyra Arsimore Elbasan
- Shkolla Profesionale Elbasan
- Qendra Kulturore e Fëmijëve Elbasan
- Forumi i Qeversisjes së Hapur, (OGP)